



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.44

1 prill

2008

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Ligj nr.9885 datë 3.3.2008	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9157, datë 4.12.2003 “Për përgjimin e telekomunikimeve” 1985
Ligj nr.9886 datë 10.3.2008	Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Austrisë për shmangien e tatimit të dyfishtë, lidhur me tatimin mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin dhe për parandalimin e evazionit fiskal” 1987
Ligj nr.9887 datë 10.3.2008	Për mbrojtjen e të dhënave personale 2001
Ligj nr.9888 datë 10.3.2008	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8328, datë 16.4.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”, të ndryshuar 2013
Vendim i KKRT nr.677, datë 18.2.2008	Për dhënie licence për televizionin privat satelitor “TV Vizion+” 2022
Vendim i KKRT nr.679, datë 18.2.2008	Për licencën e subjektit televiziv privat kabllor “TV kabllor BLU” 2023
Kërkesë e MPPTT nr.2075, datë 19.3.2008	Për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme pronë private, që preken si rezultat i rehabilitimit dhe zgjerimit të fushës së mbetjeve urbane të qytetit të Tiranës, në fshatin Sharrë 2023

LIGJ
Nr.9885, datë 3.3.2008

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.9157, DATË 4.12.2003
“PËR PËRGJIMIN E TELEKOMUNIKIMEVE”

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.9157, datë 4.12.2003 “Për përgjimin e telekomunikimeve”, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 10, në fund të shkronjës “a” shtohen fjalët “ose në seksionin e përgjimeve të Policisë së Shtetit dhe të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Ministrinë e Brendshme, sipas rastit”.

Neni 2

Në nenin 12 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Në fund të pikës 1 shtohet një fjali me këtë përmbajtje:

“Proceset teknike të përgjimit, për llogari të Policisë së Shtetit dhe të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Ministrinë e Brendshme, realizohen nëpërmjet seksionit të tyre të përgjimeve, të atashuar në sektorin e përgjimeve në SHISH.”.

b) Në pikën 2, pas fjalëve “Punonjësit e sektorit të përgjimeve në SHISH” shtohen fjalët “dhe punonjësit e seksionit të përgjimeve të Policisë së Shtetit dhe të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Ministrinë e Brendshme, të atashuar në sektorin e përgjimeve në SHISH”.

c) Në pikën 3, pas fjalëve “sektori i përgjimeve në SHISH” shtohen fjalët “dhe seksioni i përgjimeve të Policisë së Shtetit dhe të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Ministrinë e Brendshme”.

Neni 3

Në nenin 13, pas fjalëve “sektori i përgjimeve në SHISH” shtohen fjalët “dhe seksioni i përgjimeve të Policisë së Shtetit dhe të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Ministrinë e Brendshme”.

Neni 4

Në nenin 17 pika 1 bëhen shtesat si më poshtë:

a) Në fjalinë e dytë, pas fjalëve “e sektorit të përgjimeve në SHISH” shtohen fjalët “ose seksionit të përgjimeve të Policisë së Shtetit dhe të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Ministrinë e Brendshme”.

b) Në fjalinë e tretë, pas fjalëve “specialistët e sektorit të përgjimeve” shtohen fjalët “ose të seksionit të përgjimeve të Policisë së Shtetit dhe të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Ministrinë e Brendshme”.

Neni 5

Neni 19 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 19

Përgjimi me kërkesë të shërbimeve të huaja informative/police

Me kërkesë të shërbimeve të huaja informative/police dhe me miratimin e Prokurorit të Përgjithshëm, sektori i përgjimeve në SHISH ose seksioni i përgjimeve të Policisë së Shtetit dhe të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Ministrinë e Brendshme mund të realizojë, sipas rastit, përgjimin, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, për llogari të shërbimit informativ/police të huaj.”.

Neni 6

Në nenin 20, pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Në rast se kërkesa refuzohet, materiali i përgjimit asgjësohet menjëherë, sipas mënyrës së përcaktuar nga Prokurori i Përgjithshëm, Ministri i Brendshëm dhe Drejtori i SHISH-it.”.

Neni 7

Në nenin 22 pika 1, pas fjalëve “Drejtori i SHISH-it” shtohen fjalët “ose Ministri i Brendshëm, sipas rastit”.

Neni 8

Neni 23 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 23

Përgjimet me vendim gjykatë

1. Prokurori i Përgjithshëm ose prokurori i autorizuar prej tij, me akt zyrtar, bashkëshoqëron dhe komunikon vendimin e gjykatës në sektorin e përgjimeve.

2. Pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, procesi teknike të përgjimit të komunikimeve, nëpërmjet pajisjeve të telekomunikacionit, për nevoja të hetimeve paraprake, sipas procedurave të përcaktuara në nenet 221 deri 226 të Kodit të Procedurës Penale, kryhen në mjediset e zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm, në përputhje me ligjin.

Përgjimet e autorizuara para hyrjes në fuqi të këtij ligji, brenda kushteve të sigurisë teknike, të transferohen në pajisjen e instaluar në mjediset e zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm brenda 10 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.”.

Neni 9

Në nenin 24, pas fjalëve “në bashkëpunim me” shtohen fjalët “Ministrin e Brendshëm”.

Neni 10

Kudo në ligj emërtimet “Ministria e Rendit Publik” dhe “Ministri i Rendit Publik” zëvendësohen me emërtimet “Ministria e Brendshme” dhe “Ministri i Brendshëm”.

Neni 11

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.5669, datë 21.3.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

LIGJ
Nr.9886, datë 10.3.2008

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE REPUBLIKËS SË AUSTRISË PËR SHMANGIEN E TATIMIT TË DYFISHTË, LIDHUR ME TATIMIN MBI TË ARDHURAT DHE MBI KAPITALIN DHE PËR PARANDALIMIN E EVAZIONIT FISKAL”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Austrisë për shmangien e tatimit të dyfishtë, lidhur me tatimin mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin dhe për parandalimin e evazionit fiskal”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5670, datë 21.3.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

MARRËVESHJA
NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE REPUBLIKËS SË AUSTRISË PËR SHMANGIEN E TAKSIMIT TË DYFISHTË NË LIDHJE ME TATIMET MBI TË ARDHURAT DHE MBI KAPITALIN DHE PARANDALIMIN E EVAZIONIT FISKAL

Republika e Shqipërisë dhe Republika e Austrisë,
me qëllim zhvillimin e mëtejshëm dhe lehtësimin e marrëdhënieve të tyre ekonomike;
duke dëshiruar të përfundojnë një marrëveshje për eliminimin e tatimeve të dyfishta në lidhje me tatimet mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin dhe parandalimin e evazionit fiskal,
kanë rënë dakord për sa më poshtë:

Neni 1

Personat e mbuluar nga Marrëveshja

Kjo Marrëveshje do të zbatohet ndaj personave që janë rezidentë të njërit ose të dy Shteteve Kontraktuese.

Neni 2

Tatimet që mbulon Marrëveshja

1. Kjo Marrëveshje do të zbatohet për tatimet mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin, të vendosura në emër të një Shteti Kontraktues ose të nënndarjeve të tij politike ose autoriteteve lokale, pavarësisht nga mënyra e vjeljes së tyre.

2. Do të konsiderohen tatime mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin të gjitha tatimet e vendosura mbi të ardhurat totale, mbi kapitalin total ose mbi elemente të të ardhurave ose të kapitalit.

3. Tatimet ekzistuese ndaj të cilave do të zbatohet Marrëveshja janë në veçanti:
- a) Në Shqipëri:
 - i) tatimi mbi të ardhurat (duke përfshirë tatim-fitimin e korporatës dhe tatimin mbi të ardhurat personale);
 - ii) tatimi mbi aktivitetet e biznesit të vogël; dhe
 - iii) tatimi mbi pasurinë; (këtu e tutje referuar si “tatimet shqiptare”).
 - b) Në Austri:
 - i) tatimi mbi të ardhurat (die Einkommensteuer);
 - ii) tatimi mbi fitimin e korporatës (die Körperschaftsteuer);
 - iii) tatimi mbi tokën (die Grundsteuer);
 - iv) tatimi mbi ndërmarrjet bujqësore dhe pyjore (die Abgabe von land-und forstwirtschaftlichen Betrieben);
 - v) tatimi mbi vlerën e parcelave boshe (die Abgabe vom Bodenwert bei unbebauten Grundstücken); (këtu e tutje referuar si “tatimet austriake”).

4. Marrëveshja do të zbatohet gjithashtu për çdo tatim të njëjlojtë ose tepër të ngjashëm, të cilat vendosen pas datës së nënshkrimit të Marrëveshjes, si shtojcë ose në vend të tatimeve ekzistuese. Autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese do të njoftojnë njëra-tjetrën për çdo ndryshim thelbësor që është bërë në ligjet e tyre përkatëse tatimore.

Neni 3

Përkufizime të përgjithshme

1. Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, për sa kohë që konteksti nuk e kërkon ndryshe:
- a) termat “Shtet Kontraktues” dhe “Shteti tjetër Kontraktues” nënkuptojnë Shqipërinë ose Austrinë, siç e kërkon konteksti;
 - b) termi “Shqipëria” nënkupton Republikën e Shqipërisë dhe kur përdoret në kontekstin gjeografik, nënkupton territorin e Republikës së Shqipërisë, përfshirë ujërat territoriale dhe hapësirën ajrore mbi to, si dhe çdo zonë përtej ujërave territoriale të Republikës së Shqipërisë, e cila, në përputhje me të drejtën ndërkombëtare dhe me ligjet e saj, është një zonë brenda së cilës Republika e Shqipërisë ushtron të drejtat e saj në lidhje me shtratin detar dhe nëntokën dhe burimet e tyre natyrore;
 - c) termi “Austria” nënkupton Republikën e Austrisë;
 - d) termi “person” përfshin një individ, një shoqëri dhe çdo grup tjetër personash;
 - e) termi “shoqëri” nënkupton çdo ent ligjor, i cili trajtohet si person juridik për qëllime tatimore;
 - f) termat “ndërmarrje e një Shteti Kontraktues” dhe “ndërmarrje e Shtetit tjetër Kontraktues” nënkuptojnë përkatësisht një ndërmarrje të ushtruar nga një rezident i një Shteti Kontraktues dhe një ndërmarrje të ushtruar nga një rezident i Shtetit tjetër Kontraktues;
 - g) termi “trafik ndërkombëtar” nënkupton çdo transport me anije ose avion, të operuar nga një ndërmarrje që e ka vendin e drejtimit të saj efektiv në një Shtet Kontraktues, përveç kur anija ose avioni operojnë vetëm midis vendeve në Shtetin tjetër Kontraktues;
 - h) termi “autoritet kompetent” nënkupton:
 - i) në rastin e Shqipërisë: Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve;
 - ii) në rastin e Austrisë: Ministrin Federal të Financave ose përfaqësuesin e tij të autorizuar;
 - i) termi “nënshtetas” nënkupton:
 - i) çdo individ që ka nënshtetësinë e një Shteti Kontraktues;
 - ii) çdo person juridik, ortakëri ose shoqatë që gëzon statusin si i tillë, në përputhje me ligjet në fuqi në një Shtet Kontraktues.
2. Përsa i përket zbatimit të Marrëveshjes, në çdo kohë nga një Shtet Kontraktues, çdo term që nuk është përcaktuar këtu, përveç kur konteksti e kërkon ndryshe, do të ketë kuptimin që i është dhënë në atë kohë sipas legjislacionit të atij shteti për qëllimet e tatimeve ndaj të cilave zbatohet Marrëveshja. Çdo kuptim i një termi sipas ligjeve tatimore të zbatueshme të atij Shteti do të ketë përparësi mbi kuptimin që i jepet atij termi sipas ligjeve të tjera të atij Shteti.

Neni 4 Rezidenti

1. Për qëllime të kësaj Marrëveshjeje, termi “rezident i një Shteti Kontraktues” nënkupton çdo person që, sipas ligjeve të atij shteti, është subjekti i tatimeve atje për shkak të vendbanimit, rezidencës, vendit të drejtimit, vendit të regjistrimit apo çdo kriteri tjetër të një natyre të ngjashme dhe gjithashtu përfshin atë shtet dhe çdo nënndarje politike apo autoritet lokal të tij. Megjithatë, ky term nuk përfshin personat që i nënshtrohen tatimit në atë shtet vetëm për të ardhurat nga burimet në atë shtet apo kapitalit të vendosur aty.

2. Kur për shkak të dispozitave të paragrafit 1, një individ është rezident i të dy Shteteve Kontraktuese, atëherë statusi i tij do të përcaktohet si më poshtë:

a) ai do të konsiderohet rezident vetëm i shtetit në të cilin ka banesë të përshtatshme në dispozicion të tij; në qoftë se ai ka një banesë të përhershme në dispozicion të tij në të dy shtetet, ai do të konsiderohet rezident vetëm i shtetit me të cilin interesat e tij personale dhe ekonomike janë të lidhura më ngushtësisht (qendra e interesave jetike);

b) në qoftë se shteti në të cilin ai ka qendrën e interesave jetike nuk mund të përcaktohet ose në qoftë se ai nuk ka banesë të përhershme në dispozicion të tij në asnjërin shtet, ai do të konsiderohet rezident vetëm i shtetit në të cilin ai banon rregullisht;

c) në qoftë se ai banon rregullisht në të dy shtetet ose në asnjërin prej tyre, ai do të konsiderohet rezident vetëm i shtetit nënshtetas i të cilit ai është;

d) në qoftë se ai është nënshtetas i të dy shteteve ose i asnjërit prej tyre, autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese do ta zgjidhin çështjen me mirëkuptim reciprok.

3. Kur për shkak të dispozitave të paragrafit 1, një person juridik është rezident i të dy Shteteve Kontraktuese, atëherë ai do të konsiderohet rezident i shtetit në të cilin ndodhet vendi i tij i drejtimit efektiv.

Neni 5 Selia e përhershme

1. Për qëllime të kësaj Marrëveshjeje, termi “seli e përhershme” nënkupton një vend fiks biznesi, nëpërmjet të cilit ushtrohet tërësisht ose pjesërisht aktiviteti i një ndërmarrjeje.

2. Termi “seli e përhershme” përfshin në veçanti:

a) një vend drejtimi;

b) një degë;

c) një zyrë;

d) një fabrikë;

e) një punishte;

f) një minierë, një pus naftë ose gazi, një gurore ose çdo vend tjetër për nxjerrjen e burimeve natyrore.

3. Termi “seli e përhershme” përfshin gjithashtu:

a) një shesh ndërtimi, një konstruksion, projekt montimi ose instalimi, ose projekte mbikëqyrëse të lidhura me to, por vetëm kur një shesh i tillë, projekte ose aktivitete vazhdojnë për një periudhë prej më shumë se nëntë muaj në vitin përkatës kalendarik dhe

b) furnizimin e shërbimeve, përfshirë shërbime konsulence, nga një ndërmarrje nëpërmjet të punësuarve apo edhe personelit tjetër të angazhuar nga ndërmarrja për këtë qëllim, por vetëm kur aktivitetet të kësaj natyre vazhdojnë brenda vendit për një periudhë ose periudha që në total i kalojnë gjashtë muaj në vitin përkatës kalendarik.

4. Pavarësisht nga dispozitat e mësipërme të këtij neni, termi “seli e përhershme” nuk do të përfshijë:

a) përdorimin e mjediseve vetëm për qëllime magazinimi, ekspozimi ose shpërndarjeje të mallrave ose të mirave që i përkasin sipërmarrjes;

b) mirëmbajtjen e një gjendjeje mallrash ose të mirave që i përkasin ndërmarrjes vetëm për qëllime magazinimi, ekspozimi ose shpërndarjeje;

c) mirëmbajtjen e një gjendjeje mallrash ose të mirave që i përkasin sipërmarrjes vetëm për qëllime përpunimi nga një sipërmarrje tjetër;

d) mirëmbajtjen e një vendi fiks biznesi vetëm për qëllim të blerjes së mallrave ose të të mirave për mbledhje informacioni për ndërmarrjen;

e) mirëmbajtjen e një vendi fiks biznesi vetëm për qëllim ushtrimi, për ndërmarrjen, të çdo aktiviteti tjetër me karakter përgatitor ose ndihmës;

f) mirëmbajtjen e një vendi fiks biznesi vetëm për çdo kombinim të aktiviteteve të përmendura në nënparagrafët “a” deri “e”, me kusht që i tërë aktiviteti i vendit fiks të biznesit që rezulton nga ky kombinim të jetë i një karakteri përgatitor ose ndihmës.

5. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2, kur një person i ndryshëm nga një agjent me status të pavarur ndaj të cilit zbatohet paragrafi 6, vepron në emër të një ndërmarrjeje dhe ka dhe zakonisht ushtron në një Shtet Kontraktues autoritet për të përfunduar kontrata në emër të ndërmarrjes, ajo ndërmarrje do të konsiderohet të ketë seli të përhershme në atë shtet në lidhje me çdo aktivitet që ai person ushtron për ndërmarrjen, përveç kur aktivitetet e këtij personi kufizohen në ato të përmendura në paragrafin 4 që, nëse ushtrohen nëpërmjet një vendi fiks biznesi, nuk do ta bënin këtë vend fiks biznesi një seli të përhershme sipas dispozitave të atij paragrafi.

6. Një ndërmarrje nuk do të konsiderohet të ketë seli të përhershme në një Shtet Kontraktues vetëm për faktin se ajo ushtron biznes në atë shtet nëpërmjet një ndërmjetësi, komisionari të përgjithshëm apo çdo agjenti tjetër me status të pavarur, me kusht që persona të tillë të veprojnë brenda kuadrit të zakonshëm në aktivitetet e tyre.

7. Fakti që një shoqëri që është rezidente e një Shteti Kontraktues kontrollon ose kontrollohet nga një shoqëri që është rezidente e Shtetit tjetër Kontraktues ose që ushtron aktivitet në atë shtet tjetër (nëpërmjet një selie të përhershme ose në forma të tjera) nuk përbën në vetvete arsye të mjaftueshme për të konsideruar një kompani seli të përhershme të tjetrës.

Neni 6

Të ardhurat nga pasuria e paluajtshme

1. Të ardhurat që lindin nga një rezident i një Shteti Kontraktues nga pasuria e paluajtshme (përfshirë të ardhurat nga bujqësia ose pyjet) të vendosura në Shtetin tjetër Kontraktues, mund të taten në atë shtet tjetër.

2. Termi “pasuri e paluajtshme” do të ketë kuptimin që ka sipas ligjit të Shtetit Kontraktues ku është vendosur prona në fjalë. Në çdo rast, ky term do të përfshijë pasuritë dytësore të pasurisë së paluajtshme, bagëtinë dhe pajisjet e përdorura në bujqësi dhe pyje, të drejtat ndaj të cilave zbatohen dispozitat e legjislacionit të përgjithshëm në lidhje me pronën mbi tokën, uzufuktin e pasurive të paluajtshme dhe të drejtat ndaj pagesave fikse ose variabël për shfrytëzimin ose të drejtën për të shfrytëzuar vendburimet minerare dhe burime e pasuri të tjera natyrore. Anijet, barkat dhe avionët nuk konsiderohen pasuri të paluajtshme.

3. Dispozitat e paragrafit 1 do të zbatohen ndaj të ardhurave që rrjedhin nga përdorimi direkt, dhënia me qira ose përdorimi në çdo formë tjetër i pasurive të paluajtshme.

4. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 3 do të zbatohen gjithashtu ndaj të ardhurave nga pasuria e paluajtshme e një ndërmarrjeje dhe ndaj të ardhurave nga pasuria e paluajtshme e përdorur për kryerjen e shërbimeve personale të pavarura.

Neni 7

Fitimet nga biznesi

1. Fitimet e një ndërmarrjeje të një Shteti Kontraktues do të taten vetëm në atë shtet, përveç kur ndërmarrja ushtron biznes në Shtetin tjetër Kontraktues nëpërmjet një selie të përhershme të vendosur atje. Në qoftë se ndërmarrja e ushtron aktivitetin në mënyrën e sipërpërmendur, fitimet e ndërmarrjes mund të taten në shtetin tjetër, por vetëm ajo pjesë e tyre që i atribuohet asaj selie të përhershme.

2. Duke iu nënshtruar dispozitave të paragrafit 3, kur një ndërmarrje e një Shteti Kontraktues ushtron biznes në Shtetin tjetër Kontraktues nëpërmjet një selie të përhershme të vendosur aty, atëherë në secilin Shtet Kontraktues, selisë së përhershme do t'i atribuohen fitimet që do të pritej të nxirrte sikur ajo të ishte sipërmarrje e veçantë dhe e pavarur që do të angazhohej në të njëjtin aktivitet ose në aktivitete të ngjashme, nën kushte të njëjta ose të ngjashme dhe që vepron tërësisht e pavarur me ndërmarrjen, seli e përhershme e së cilës ajo është.

3. Në përcaktimin e fitimeve të një selie të përhershme, do të lejohet zbritja e shpenzimeve që janë kryer për qëllime të biznesit të selisë së përhershme, përfshirë shpenzimet e përgjithshme administrative dhe ekzekutive të kryera për këtë qëllim, si në shtetin ku ndodhet selia e përhershme, ashtu edhe diku tjetër.

4. Kur në një Shtet Kontraktues përcaktimi i fitimeve, që do t'i atribuohen një selie të përhershme, zakonisht bëhet në bazë të ndarjes të fitimeve totale të ndërmarrjes midis pjesëve të ndryshme të saj, dispozitat e paragrafit 2 nuk e përjashtojnë atë Shtet Kontraktues nga përcaktimi i fitimeve që do të taton në bazë të një ndarjeje të tillë siç mund të bëhet zakonisht, megjithatë metoda e miratuar e ndarjes së fitimeve duhet të jetë e tillë që rezultati të jetë në përputhje me parimet që përmban ky nen.

5. Asnjë fitim nuk do t'i atribuohet një selie të përhershme vetëm për faktin se ajo thjesht blen mallra për ndërmarrjen nëpërmjet kësaj selie të përhershme.

6. Për qëllime të paragrafëve të mësipërm, fitimet që duhet t'i atribuohen selisë së përhershme do të përcaktohen me të njëjtën metodë vit pas viti, për sa kohë që nuk ka arsye të drejta dhe të mjaftueshme për të vepruar ndryshe.

7. Kur fitimet përfshijnë zëra të të ardhurave që trajtohen veçmas në nene të tjera të kësaj Marrëveshjeje, atëherë dispozitat e atyre neneve nuk do të ndikohen nga dispozitat e këtij neni.

Neni 8

Transporti detar në ujërat e brendshme dhe transporti ajror

1. Fitimet nga veprimtaria e anijeve ose avionëve në trafikun ndërkombëtar do të tatonen vetëm në Shtetin Kontraktues ku ndodhet vendi i drejtimit efektiv të ndërmarrjes.

2. Fitimet nga përdorimi i/e lundrave të transportit në ujërat e brendshme do të tatonen vetëm në Shtetin Kontraktues ku ndodhet vendi i drejtimit efektiv të ndërmarrjes.

3. Nëse vendi i drejtimit efektiv të një ndërmarrjeje detare transporti ose të transportit në ujërat e brendshme është në bordin e një anijeje ose lundre, atëherë ai do të konsiderohet i vendosur në Shtetin Kontraktues në të cilin ndodhet porti i qëndrimit të zakonshëm të anijes ose nëse nuk ka një port të tillë, në Shtetin Kontraktues, rezident i të cilit është përdoruesi i anijes ose lundrës.

4. Dispozitat e paragrafit 1 do të zbatohen gjithashtu ndaj fitimeve nga pjesëmarrja në një ortakëri, një biznes të përbashkët ose në një agjenci ndërkombëtare operuese.

Neni 9

Ndërmarrje të lidhura

1. Kur:

a) një ndërmarrje e një Shteti Kontraktues merr pjesë direkt ose indirekt në drejtimin, kontrollin apo kapitalin e një ndërmarrjeje të Shtetit tjetër Kontraktues, ose

b) të njëjtët persona marrin pjesë direkt ose indirekt në drejtimin, kontrollin apo kapitalin e një ndërmarrjeje të një Shteti Kontraktues dhe të një ndërmarrjeje të Shtetit tjetër Kontraktues, dhe në secilin rast, janë vënë ose diktuar kushte midis dy ndërmarrjeve në marrëdhëniet e tyre tregtare apo financiare, që ndryshojnë nga ato që do të vendoseshin midis ndërmarrjeve të pavarura, atëherë çdo fitim që do të realizohet nga njëra ndërmarrje, por që për shkak të atyre kushteve nuk është realizuar, mund të përfshihet në fitimet e asaj ndërmarrjeje dhe të tatonet normalisht.

2. Kur një Shtet Kontraktues përfshin në fitimet e një ndërmarrjeje të atij shteti dhe i taton ato normalisht, fitimet për të cilat një ndërmarrje e Shtetit tjetër Kontraktues i është nënshtruar tatimit në atë shtet tjetër, dhe fitimet e përfshira në këtë mënyrë janë fitime që do të realizoheshin nga ndërmarrja e shtetit të përmendur në fillim nëse kushtet e vendosura midis dy ndërmarrjeve do të ishin ato që do të vendoseshin midis ndërmarrjeve të pavarura, atëherë ai shtet do të bëjë rregullimin e duhur në shumën e tatimit të vendosur mbi ato fitime.

Në përcaktimin e këtij rregullimi do të mbahen parasysh edhe dispozitat e tjera të kësaj Marrëveshjeje dhe autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese, në rast nevoje, do të konsultohen me njëra-tjetrën.

Neni 10 **Devidendët**

1. Devidendët e paguar nga një shoqëri që është rezidente e një Shteti Kontraktues ndaj një rezidenti të Shtetit tjetër Kontraktues, mund të taten në atë shtet tjetër.

2. Megjithatë, këta devidendë mund të taten gjithashtu në Shtetin Kontraktues, rezidente e të cilit është shoqëria paguese e devidendëve dhe në përputhje me ligjet e atij shteti, por nëse pronari përfitues i devidendëve është rezident i Shtetit tjetër Kontraktues, tatimi i vendosur nuk do të kalojë:

a) 5 për qind të shumës bruto të devidendëve, nëse pronari përfitues është një shoqëri (përveç ortakërive) që zotëron direkt të paktën 25 për qind të kapitalit të shoqërisë paguese të devidendëve;

b) në të gjitha rastet e tjera, 15 për qind të shumës bruto të devidendëve.

Autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese do të vendosin me mirëkuptim reciprok mënyrën e zbatimit të këtyre kufizimeve.

Dispozitat e këtij paragrafi nuk do të cenojnë tatimin e shoqërisë në lidhje me fitimet nga të cilat janë paguar devidendët.

3. Termi “devidend”, sikurse përdoret në këtë nen, nënkupton të ardhurat nga aksionet e çdo lloji ose të drejta të tjera që nuk janë pretendime borxhi, pjesëmarrjen në fitime, si dhe të ardhura të tjera të përbashkëta, të cilat i nënshtrohen të njëjtit trajtim tatimor si të ardhurat nga aksionet sipas legjislacionit të shtetit, rezidente e të cilit është shoqëria që bën shpërndarjen.

4. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 nuk do të zbatohen nëse pronari përfitues i devidendëve, duke qenë rezident i një Shteti Kontraktues, ushtron aktivitet në Shtetin tjetër Kontraktues, rezidente e të cilit është shoqëria paguese e devidendëve nëpërmjet një selie të përhershme të vendosur aty, ose kryen në atë shtet tjetër shërbime personale të pavarura nga një bazë fikse e vendosur aty, dhe zotërimi lidhur me të cilin janë paguar devidendët është efektivisht i lidhur me këtë seli të përhershme ose bazë fikse. Në këtë rast, do të zbatohen dispozitat e nenit 7 ose nenit 14, sipas rastit.

5. Kur një shoqëri që është rezidente e një Shteti Kontraktues nxjerr fitime ose të ardhura nga Shteti tjetër Kontraktues, ai shtet tjetër mund të mos vendosë tatim mbi devidendët e paguar nga shoqëria, përveç kur këta devidendë i paguhen një rezidenti të shtetit tjetër ose kur zotërimi lidhur me të cilin janë paguar devidendët është efektivisht i lidhur me një seli të përhershme ose bazë fikse të vendosur në atë shtet tjetër; subjekt i tatimit mbi fitimet e pashpërndara të shoqërisë nuk janë gjithashtu as fitimet e pashpërndara të shoqërisë, edhe sikur devidendët e paguar ose fitimet e pashpërndara përbëhen tërësisht ose pjesërisht nga fitimet apo të ardhura që lindin në këtë shtet tjetër.

Neni 11 **Interesat**

1. Interesat që lindin në një Shtet Kontraktues dhe i paguhen një rezidenti të Shtetit tjetër Kontraktues, mund të taten në atë shtet tjetër.

2. Megjithatë, këto interesa mund të taten edhe në Shtetin Kontraktues ku ata lindin dhe në përputhje me ligjet e këtij shteti, por kur pronari përfitues i interesave është një rezident i Shtetit tjetër Kontraktues, tatimi i vendosur nuk duhet të kalojë 5 për qind të shumës bruto të interesit. Autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese do të vendosin me mirëkuptim reciprok mënyrën e zbatimit të këtij kufizimi.

3. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 2:

a) interesat që lindin në një Shtet Kontraktues dhe që i paguhen qeverisë së Shtetit tjetër Kontraktues do të përjashtohen nga tatimi në shtetin e përmendur në fillim;

b) interesat e paguara në lidhje me huanë ose kredinë e dhënë, garantuar ose siguruar nga banka austriake, Oesterreichische Kontrollbank AG, ose nga ente të ngjashme publike shqiptare, objektivi i të cilave është nxitja e eksportit, nuk do të taten në Shtetin Kontraktues ku lindin këto interesa.

4. Termi “interesa” në kuptimin e përdorur në këtë nen, nënkupton të ardhurat nga pretendimet e borxhit të çdo lloji, të siguruar ose jo me hipotekim dhe që e kanë ose jo të drejtën e pjesëmarrjes në fitimet e debitorit, dhe në veçanti, të ardhurat nga obligacionet shtetërore, bonot e thesarit dhe lloje të tjera letrash me vlerë, përfshirë edhe fitimet dhe shpërblimet që rrjedhin nga këto obligacione, letra me vlerë apo bono thesari. Gjjobat e vendosura për pagesa të vonuara nuk do të konsiderohen si interesat për qëllime të këtij neni.

5. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 nuk do të zbatohen, në qoftë se pronari përfitues i interesave, duke qenë rezident i një Shteti Kontraktues, ushtron biznes në Shtetin tjetër Kontraktues në të cilin lindin interesat nëpërmjet një selie të përhershme të vendosur aty, ose kryen në atë shtet tjetër shërbime personale të pavarura nga një bazë fikse e vendosur aty, dhe pretendimi i borxhit për të cilën paguhet interesi është efektivisht i lidhur me këtë seli të përhershme ose bazë fikse. Në këtë rast do të zbatohen dispozitat e nenit 7 ose 14, sipas rastit.

6. Interesat do të konsiderohen se lindin në një Shtet Kontraktues kur paguesi është vetë shteti, një nënndarje politike, autoritet lokal ose rezident i këtij shteti. Megjithatë, kur personi që paguan interesat, qoftë ose jo rezident i një Shteti Kontraktues, ka në një Shtet Kontraktues një seli të përhershme ose një bazë fikse në lidhje me të cilën ka lindur borxhi për të cilën paguhet interesi, dhe këto interesa lindin nga kjo seli e përhershme ose bazë fikse, atëherë këto interesa do të konsiderohen të lindin në shtetin ku është vendosur selia e përhershme ose baza fikse.

7. Kur për shkak të marrëdhënieve të veçanta midis paguesit dhe pronarit përfitues ose midis të dyve dhe personave të tretë, shuma e interesave, bazuar në pretendimin e borxhit për të cilin paguhet, e kalon shumën mbi të cilën duhej të ishte rënë dakord midis paguesit dhe pronarit përfitues në mungesë të marrëdhënieve të tilla, dispozitat e këtij neni do të zbatohen vetëm mbi shumën e përmendur në fund. Në këtë rast, pjesa që kalon pagesën normale do të mbetet e tatuashme në përputhje me ligjet e secilit Shtet Kontraktues, duke pasur parasysh edhe dispozitat e tjera të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 12 Honorarët

1. Honorarët që lindin në një Shtet Kontraktues dhe i paguhet një rezidenti të Shtetit tjetër Kontraktues mund të tatonen në atë shtet tjetër.

2. Megjithatë, këto honorarë mund të tatonen gjithashtu në Shtetin Kontraktues ku lindin dhe në përputhje me ligjet e atij shteti, por nëse pronari përfitues i honorarëve është rezident i Shtetit tjetër Kontraktues, tatimi i vendosur nuk duhet të kalojë 5 për qind të shumës bruto të honorarëve. Autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese do të vendosin me mirëkuptim reciprok mënyrën e zbatimit të këtij kufizimi.

3. Në funksion të këtij neni, termi “honorarë” nënkupton pagesat e çdo lloji të marra si shpërblim për përdorimin ose të drejtën e përdorimit, të çdo të drejte të autorit për veprat letrare, artistike ose pune shkencore, përfshirë filmat kinematografikë, çdo patentë, markë tregtare, skicë ose model, plan, proces ose formulë sekrete ose për informacione në lidhje me përvojën industriale, tregtare ose shkencore.

4. Dispozitat e paragrafit 1 dhe 2 nuk do të zbatohen, nëse pronari përfitues i honorarëve, duke qenë rezident i një Shteti Kontraktues, ushtron biznes në Shtetin tjetër Kontraktues ku lindin honorarët, nëpërmjet një selie të përhershme të vendosur aty ose kryen në atë shtet tjetër shërbime personale të pavarura nga një bazë fikse e vendosur aty, dhe e drejta ose prona në lidhje me të cilën paguhet honorarët është efektivisht e lidhur me këtë seli të përhershme ose bazë fikse. Në këtë rast, do të zbatohen dispozitat e nenit 7 ose nenit 14, sipas rastit.

5. Honorarët do të konsiderohen të lindin në një Shtet Kontraktues kur pagues është një rezident i atij shteti. Megjithatë, kur personi që paguan honorarët, qoftë ose jorezident i një Shteti Kontraktues, ka në një Shtet Kontraktues një seli të përhershme ose një bazë fikse në lidhje me të cilën ka lindur e drejta e pagimit të honorarëve, dhe këta honorarë kanë lindur nga kjo seli e përhershme ose bazë fikse, atëherë këta honorarë konsiderohen se kanë lindur në Shtetin Kontraktues ku është vendosur selia e përhershme ose baza fikse.

6. Kur për shkak të lidhjeve të veçanta midis paguesit dhe pronarit përfitues ose midis të dyve dhe personave të tretë, shuma e honorarëve, duke pasur parasysh përdorimin, të drejtën apo informacionin për të cilin ato janë paguar, e kalon shumë për të cilën do të ishte rënë dakord midis paguesit dhe pronarit përfitues në mungesë të marrëdhënieve të tilla, dispozitat e këtij neni do të zbatohen vetëm mbi shumën e përmendur në fund. Në këtë rast, shuma e shpërblimit që kalon shpërblimin normal do të mbetet e tatueshme sipas ligjeve të secilit Shtet Kontraktues, duke pasur parasysh dispozitat e tjera të kësaj Konvente.

Neni 13

Fitimet nga kapitali

1. Fitimet e nxjerra nga një rezident i një Shteti Kontraktues, nga tjetërsimi i pasurive të paluajtshme që i referohen nenit 6 dhe të vendosura në Shtetin tjetër Kontraktues, mund të taten në atë shtet tjetër.

2. Fitimet nga tjetërsimi i pasurive të luajtshme që bëjnë pjesë në pasurinë e biznesit të një selie të përhershme që një ndërmarrje e një Shteti Kontraktues ka në Shtetin tjetër Kontraktues ose i pasurive të luajtshme që i përkasin një baze fikse që një rezident i një Shteti Kontraktues ka në Shtetin tjetër Kontraktues për të kryer shërbime personale të pavarura, përfshirë edhe fitimet nga tjetërsimi i selisë së përhershme (vetëm ose bashkë me të gjithë ndërmarrjen) ose i kësaj baze fikse, mund të taten në atë shtet tjetër.

3. Fitimet nga tjetërsimi i anijeve ose avionëve që operojnë në trafikun ndërkombëtar, lundrat që operojnë në transportin e ujërave të brendshme ose i pasurive të luajtshme që i përkasin veprimtarisë së këtyre anijeve, avionëve ose lundrave, do të taten vetëm në Shtetin Kontraktues në të cilin ndodhet vendi i drejtimit efektiv të ndërmarrjes.

4. Fitimet nga tjetërsimi i çdo pasurie që nuk mbulohet nga paragrafët 1,2 dhe 3, do të taten vetëm në Shtetin Kontraktues, rezident i të cilit është tjetërsuesi.

Neni 14

Shërbimet personale të pavarura

1. Të ardhurat e nxjerra nga një rezident i një Shteti Kontraktues, në lidhje me shërbimet profesionale ose shërbime të tjera të ngjashme të një karakteri të pavarur, do të taten vetëm në atë shtet, përveç në rrethanat e mëposhtme, ku këto të ardhura mund të taten gjithashtu në Shtetin tjetër Kontraktues:

a) nëse ai ka një bazë fikse në Shtetin tjetër Kontraktues që rregullisht i shërben atij për kryerjen e aktiviteteve të tij; në atë rast, vetëm ajo pjesë e të ardhurave që i atribuohet asaj baze fikse mund të taten në atë shtet tjetër; ose

b) nëse qëndrimi i tij në Shtetin tjetër Kontraktues është për një periudhë ose periudha që në total arrijnë ose kalojnë 183 ditë në çdo periudhë 12-mujore, që fillon ose përfundon në vitin përkatës kalendarik; në atë rast, vetëm ajo pjesë e të ardhurave që rrjedh nga aktivitetet e tij të kryera në atë shtet tjetër, mund të taten në atë shtet tjetër.

2. Termi “shërbime profesionale” përfshin në veçanti aktivitetet e pavarura, shkencore, letrare, artistike, arsimore apo didaktike, si dhe aktivitetet e pavarura të mjekëve, dentistëve, avokatëve, inxhinierëve, arkitektëve, kontrollorëve financiarë dhe llogaritarëve.

Neni 15

Të ardhurat nga punësimi

1. Duke iu nënshtruar dispozitave të neneve 16,18,19 dhe 20, pagat dhe shpërblime të tjera të ngjashme, që përfitohen nga një rezident i një Shteti Kontraktues nga punësimi i tij, do të taten vetëm në atë shtet, përveç kur puna është ushtruar në Shtetin tjetër Kontraktues. Nëse puna ushtrohet në këtë mënyrë, atëherë këto të ardhura mund të taten në atë shtet tjetër.

2. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 1, shpërblimet e përfituara nga një rezident i një Shteti Kontraktues në lidhje me punën e ushtruar në Shtetin tjetër Kontraktues, do të taten vetëm në shtetin e përmendur në fillim, nëse:

- a) përfituesi është i pranishëm në shtetin tjetër për një periudhë ose periudha që në total nuk e kalojnë 183 ditë në çdo periudhë 12-mujore që fillon ose përfundon në vitin kalendarik përkatës;
- b) shpërblimi paguhet nga ose në emër të një punëdhënësi që nuk është rezident i shtetit tjetër;
- c) shpërblimi nuk ka lindur nga një seli e përhershme ose bazë fikse që punëdhënësi ka në shtetin tjetër.

3. Pavarësisht nga dispozitat e mësipërme të këtij neni, pagesat e kryera në lidhje me punën e ushtruar në bordin e një anijeje ose avioni që operohet në trafikun ndërkombëtar ose në bord të lundrës që operohet në transportin e ujërave të brendshme, mund të taten në Shtetin Kontraktues në të cilin është vendosur vendi i drejtimit efektiv të ndërmarrjes.

Neni 16

Shpërblimet e drejtorëve

Shpërblimet e drejtorëve dhe pagesa të tjera të ngjashme të realizuara nga një rezident i një Shteti Kontraktues në cilësinë e tij si anëtar i bordit të drejtorëve ose çdo organi të ngjashëm të një shoqërie që është rezidente e Shtetit tjetër Kontraktues, mund të taten në atë shtet tjetër.

Neni 17

Artistët dhe sportistët

1. Pavarësisht nga dispozitat e neneve 14 dhe 15, të ardhurat e nxjerra nga një rezident i një Shteti Kontraktues, si artist teatri, kinematografie, radio-televizioni, muzikant apo sportist, nga aktivitetet e tij personale si të tilla të ushtruara në Shtetin tjetër Kontraktues mund të taten në atë shtet tjetër.

2. Kur të ardhurat në lidhje me aktivitetet personale të ushtruara nga një artist ose sportist në pozitën e tij si i tillë, nxirren jo direkt nga vetë artisti apo sportisti, por nga një person tjetër, këto të ardhura, pavarësisht nga dispozitat e neneve 7, 14 dhe 15 mund të taten në Shtetin Kontraktues në të cilin janë ushtruar aktivitetet e artistit apo sportistit.

3. Dispozitat e paragrafit 1 dhe 2 nuk do të zbatohen në lidhje me të ardhurat e fituara nga aktivitetet e kryera në një Shtet Kontraktues nga artistët ose sportistët, në rastin kur vizita e tyre në këtë shtet mbështetet kryesisht ose tërësisht nga fonde publike të shtetit tjetër ose të nënndarjeve politike, të autoriteteve të tij lokale ose nga një institucion i njohur si jofitimprurës. Në këtë rast, e ardhura tatohet vetëm në Shtetin Kontraktues ku personi është rezident.

Neni 18

Pensionet

Duke iu nënshtruar dispozitave të paragrafit 2 të nenit 19, pensionet dhe shpërblime të tjera të ngjashme që i paguhet për punësimin në të kaluarën një rezidenti të një Shteti Kontraktues, do të taten vetëm në atë shtet.

Neni 19

Shërbimet qeveritare

1.a) Pagat, fitimi dhe shpërblime të tjera të ngjashme, të ndryshme nga pensionet, të paguara nga një Shtet Kontraktues ose nënndarje politike ose nga një autoritet lokal i tij, ndaj një individi në lidhje me shërbimet e kryera atij shteti, nënndarjeje, autoriteti ose enti, do të taten vetëm në atë shtet.

b) Megjithatë, këto paga, fitimi dhe shpërblime të tjera të ngjashme do të taten vetëm në Shtetin tjetër Kontraktues, nëse shërbimet janë kryer në atë shtet dhe individi është rezident i atij shteti, dhe:

- i) është nënshtruar i atij shteti ose
- ii) nuk është bërë rezident i atij shteti vetëm për qëllimin e kryerjes së këtij shërbimi.

2.a) Çdo pension i paguar nga, apo prej fondeve të krijuara nga një Shtet Kontraktues, nënndarje politike, autoritet lokal ose enti ligjor publik të tij ndaj një individi në lidhje me shërbimet e kryera ndaj atij shteti, nënndarjeje, autoriteti ose enti, do të tatohet vetëm në atë shtet.

b) Megjithatë, ky pension do të tatohet vetëm në Shtetin tjetër Kontraktues nëse individi është rezident dhe nënshtetas i atij shteti.

3. Dispozitat e neneve 15, 16, 17 dhe 18 do të zbatohen për pagat, fitimin dhe shpërblimet e tjera të ngjashme dhe për pensionet, përsa u përket shërbimeve të kryera në lidhje me një biznes të ushtruar nga një Shtet Kontraktues ose nënndarje politike, autoritetet lokale ose ent ligjor publik të tij.

Neni 20 **Studentët**

1. Kur një student apo specializant biznesi, që është ose ishte menjëherë para ardhjes në një Shtet Kontraktues rezident i Shtetit tjetër Kontraktues dhe që është i pranishëm në shtetin e përmendur në fillim vetëm për qëllim të arsimimit ose specializimit të tij, për çdo pagesë të marrë nga ky student për qëllim të mbajtjes së tij, arsimimit apo specializimit, nuk do të tatohet në atë shtet, me kusht që të tilla pagesa të lindin nga burime jashtë atij shteti.

2. Në lidhje me grantet, bursat dhe shpërblimet nga punësimi, të cilat nuk përfshihen në paragrafin 1, një student, sipas paragrafit 1, përveç kësaj, do të ketë të njëjtat përjashtime, lehtësira ose zbritje gjatë periudhës së edukimit në lidhje me trajtimin fiskal të rezidentëve të shtetit në të cilin ai është përfitues.

Neni 21 **Të ardhura të tjera**

1. Zërat e të ardhurave të një rezidenti të një Shteti Kontraktues, kudo që lindin, që nuk lidhen me nenet e mësipërme të kësaj Marrëveshjeje, do të tatohen vetëm në atë shtet.

2. Dispozitat e paragrafit 1 nuk do të zbatohen ndaj të ardhurave, që nuk janë të ardhura nga pasuria e paluajtshme, të përcaktuara në paragrafin 2 të nenit 6, nëse përfituesi i këtyre të ardhurave, duke qenë rezident i një Shteti Kontraktues, ushtron aktivitet në Shtetin tjetër Kontraktues nëpërmjet një selie të përhershme të vendosur aty, ose kryen në atë shtet tjetër shërbime personale të pavarura nga një bazë fikse e vendosur aty, dhe e drejta ose pasuria e lidhur me të cilën paguhet shpërblimi është efektivisht e lidhur me këtë seli të përhershme ose bazë fikse. Në këtë rast do të zbatohen dispozitat e nenit 7 ose nenit 14, sipas rastit.

Neni 22 **Kapitali**

1. Kapitali i përfaqësuar nga pasuri të paluajtshme të referuara në nenin 6, të zotëruara nga një rezident i një Shteti Kontraktues dhe të vendosura në Shtetin tjetër Kontraktues, mund të tatohen në atë shtet tjetër.

2. Kapitali i përfaqësuar nga pasuri të luajtshme, që bëjnë pjesë në pasurinë e biznesit të një selie të përhershme që një ndërmarrje e një Shteti Kontraktues ka në Shtetin tjetër Kontraktues ose nga pasuri të luajtshme që i përkasin një baze fikse në dispozicion të një rezidenti të një Shteti Kontraktues në Shtetin tjetër Kontraktues, për kryerjen e shërbimeve personale të pavarura, mund të tatohet në këtë shtet tjetër.

3. Kapitali i përfaqësuar nga anije dhe avionë që operojnë në trafikun ndërkombëtar dhe anije që operojnë në transportin e ujrave të brendshme dhe nga pasuritë e luajtshme që i përkasin aktivitetit të këtyre anijeve, avionëve dhe lundrave, do të tatohet vetëm në Shtetin Kontraktues ku ndodhet vendi i drejtimit efektiv të ndërmarrjes.

4. Të gjitha elementet e tjera të kapitalit të një rezidenti të një Shteti Kontraktues do të tatohen vetëm në atë shtet.

Neni 23 **Eliminimi i tatimit të dyfishtë**

Tatimi i dyfishtë do të eliminohet në mënyrën e mëposhtme:

1. Në Shqipëri:

a) Kur një rezident i Shqipërisë nxjerr të ardhura ose zotëron kapitale, të cilat, në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje, mund të taten në Austri, Shqipëria do të lejojë:

i) si zbritje nga tatimi shqiptar mbi të ardhurat e atij rezidenti, të një shume të barabartë me tatimin mbi të ardhurat të paguar në Austri.

ii) si zbritje nga tatimi shqiptar mbi kapitalin e atij rezidenti, të një shume të barabartë me tatimin mbi kapitalin të paguar në Austri.

Megjithatë, kjo zbritje, në çdo rast, nuk do të kalojë atë pjesë të tatimit shqiptar mbi të ardhurat ose kapitalin, të llogaritur para dhënies së zbritjes, që i atribuohet, sipas rastit, të ardhurave ose kapitalit që mund të taten në Austri.

b) Kur në përputhje me dispozitat e Marrëveshjes, të ardhurat e nxjerra ose kapitali i zotëruar nga një rezident i Shqipërisë përjashtohet nga tatimi në Shqipëri, në llogaritjen e shumës së tatimit mbi të ardhurat ose kapitalin e mbetur të këtij rezidenti Shqipëria merr parasysh të ardhurat ose kapitalin e përjashtuar.

2. Në Austri:

a) Kur një rezident i Austrisë nxjerr të ardhura ose zotëron kapital që, në përputhje me dispozitat e kësaj Konvente, mund të taten në Shqipëri, Austria, në bazë të nënparagrafëve (b) dhe (c) të këtij neni, mund të përjashtojë nga tatimi një të ardhur të tillë ose kapital.

b) Kur një rezident i Austrisë nxjerr zëra të të ardhurave të cilat, në përputhje me dispozitat e neneve 10, 11 dhe 12, mund të taten në Shqipëri, Austria do të lejojë, si zbritje nga tatimi mbi të ardhurat e atij rezidenti, një shumë të barabartë me shumën e tatimit të paguar në Shqipëri. Megjithatë, një zbritje e tillë nuk do ta tejkalojë pjesën e tatimit të llogaritur para se të njihet zbritja, që u atribuohet këtyre zërave të të ardhurave të nxjerra nga Shqipëria.

c) Kur, në përputhje me dispozitat e Marrëveshjes, të ardhurat nga kapitali i zotëruar nga një rezident i Austrisë, përjashtohen nga tatimi në Austri, pavarësisht nga kjo, në llogaritjen e tatimit mbi pjesën e mbetur të të ardhurave totale ose të të ardhurave nga kapitali i këtij rezidenti, Austria mund të marrë parasysh të ardhurën ose kapitalin e përjashtuar.

d) Dispozitat e nënparagrafit (a) nuk do të zbatohen për të ardhurat e nxjerra ose kapitalin në pronësi të një rezidenti nga Austria, në rastin kur Shqipëria zbaton dispozitat e kësaj Marrëveshjeje për ta përjashtuar këtë të ardhur ose kapital nga tatimet ose zbaton dispozitat e paragrafit 2 të neneve 10, 11 ose 12 në lidhje me këtë të ardhur.

Neni 24
Mosdiskriminimi

1. Nënshetasit e një Shteti Kontraktues nuk do të jenë në Shtetin tjetër Kontraktues subjekt i ndonjë tatimi ose kërkesë të lidhur me të, që të jetë më i rëndësishëm sesa tatimi dhe kërkesat e lidhura me të, të cilave mund apo i nënshtrohen nënshetasit e këtij shteti tjetër në rrethana të njëjta, në veçanti në lidhje me rezidencën. Kjo dispozitë, pavarësisht nga dispozitat e nenit 1, do të zbatohet gjithashtu ndaj personave që nuk janë rezidentë të njërit apo të dy Shteteve Kontraktuese.

2. Tatimi i një selie të përhershme që një ndërmarrje e një Shteti Kontraktues ka në Shtetin tjetër Kontraktues nuk do të jetë më pak i favorshëm në këtë shtet tjetër sesa tatimi i vjelë ndaj ndërmarrjeve ose rezidentëve të atij shteti tjetër, që ushtrojnë aktivitete të njëjta. Kjo dispozitë nuk do të interpretohet si detyrim i njërit Shtet Kontraktues për t'u garantuar rezidentëve të Shtetit tjetër Kontraktues rimbursime, lehtësira personale dhe reduktime për qëllime tatimore nga ato që u garanton rezidentëve të vet për gjendjen civile ose përgjegjësitë familjare.

3. Përjashtuar rastet kur zbatohen dispozitat e paragrafit 1 të nenit 9, paragrafit 7 të nenit 11 ose paragrafit 6 të nenit 12, interesat, honorarët dhe disbursime të tjera të paguara nga një ndërmarrje e një Shteti Kontraktues ndaj një rezidenti të Shtetit tjetër Kontraktues, për efekt të përcaktimit të fitimeve të tatueshme të kësaj ndërmarrjeje, do të jenë të reduktueshme nën të njëjtat kushte, sikur t'i ishin paguar një rezidenti të shtetit të përmendur në fillim. Në mënyrë të ngjashme, çdo borxh i një ndërmarrjeje të një Shteti Kontraktues ndaj një rezidenti të Shtetit tjetër Kontraktues, për efekt të përcaktimit të kapitalit të tatueshëm të kësaj ndërmarrjeje, do të jetë i reduktueshëm nën të njëjtat kushte sikur të ishte kontraktuar ndaj një rezidenti të shtetit të përmendur në fillim.

4. Ndërmarrjet e një Shteti Kontraktues, kapitali i të cilave është totalisht ose pjesërisht i zotëruar ose kontrolluar, direkt ose indirekt, nga një ose më shumë rezidentë të Shtetit tjetër Kontraktues, nuk do të jenë në shtetin e përmendur në fillim subjekt i ndonjë tatimi ose kërkesë të lidhur me të, që të jetë më i rëndë sesa tatimi dhe kërkesat e lidhura me të, të cilave u nënshtrohen apo mund t'u nënshtrohen ndërmarrje të tjera të ngjashme të shtetit të përmendur në fillim.

Neni 25

Procedura e mirëkuptimit reciprok

1. Kur një person mendon se veprimet e njërit apo të dy Shteteve Kontraktuese e rëndojnë apo do ta rëndojnë atë me tatime që nuk janë në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje, pavarësisht nga zgjidhjet ligjore të parashikuara në legjislacionin e brendshëm të atyre shteteve, ai mund t'ia paraqesë çështjen e tij autoritetit kompetent të Shtetit Kontraktues, rezident i të cilit ai është, ose, nëse çështja e tij mbulohet nga paragrafi 1 i nenit 24, ai mund t'ia paraqesë atë Shtetit Kontraktues, nënshtetas i të cilit ai është. Çështja duhet të paraqitet brenda tre vjetëve nga njoftimi i parë lidhur me veprimin që ka rezultuar në tatimin që nuk është në përputhje me dispozitat e Marrëveshjes.

2. Nëse kërkesa i duket e justifikuar dhe ai vetë nuk e ka të mundur arritjen e një zgjidhjeje të kënaqshme, autoriteti kompetent do të përpiqet ta zgjidhë çështjen me mirëkuptim reciprok me autoritetin kompetent të Shtetit tjetër Kontraktues, me synim shmangien e tatimit që nuk është në përputhje me Marrëveshjen. Çdo marrëveshje e arritur do të zbatohet pavarësisht nga kufizimet kohore të përcaktuara nga ligjet e brendshme të Shteteve Kontraktuese.

3. Autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese do të përpiqen që me mirëkuptim reciprok të zgjidhin çdo vështirësi apo dyshim që lind nga interpretimi apo zbatimimi i Marrëveshjes. Ata gjithashtu mund të konsultohen me njëri-tjetrin për eliminimin e tatimit të dyfishtë, për rastet të cilat nuk parashikohen nga kjo Konventë.

4. Autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese mund të komunikojnë me njëri-tjetrin në mënyrë direkte, duke përfshirë këtu dhe ngritjen e komisioneve të përbashkëta, të përbëra nga vetë këto autoritete ose përfaqësuesit e tyre, me qëllim arritjen e një marrëveshjeje, në kuptimin e paragrafëve të mësipërm.

Neni 26

Shkëmbimi i informacionit

1. Autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese do të shkëmbejnë informacionet e nevojshme për zbatimin e dispozitave të kësaj Konvente ose të ligjeve të brendshme në lidhje me tatimet e çdo lloji dhe përshkrimin e vendosur mbi to në emër të Shteteve Kontraktuese ose të nënndarjeve politike ose autoriteteve lokale të tyre, përderisa ato tatime nuk janë në kundërshtim me Marrëveshjen. Shkëmbimi i informacionit nuk kufizohet nga neni 1 dhe neni 2. Çdo informacion i marrë nga një Shtet Kontraktues do të trajtohet si sekret, në të njëjtën mënyrë si informacioni i marrë nën legjislacionin e brendshëm të atij shteti dhe do t'i serviret vetëm personave apo autoriteteve (përfshirë gjykatat dhe organet administrative) të përfshira në llogaritjen apo mbledhjen e tatimeve, me përmbardimin ose ndjekjen penale në lidhje me përcaktimin e apeleve për sa u përket tatimeve të referuara në fjalinë e parë. Këto persona apo autoritete do ta përdorin informacionin vetëm për këto qëllime. Ata mund ta servirin informacionin në procedimet gjyqësore me dyer të hapura apo në vendimet gjyqësore.

2. Në asnjë rast, dispozitat e paragrafit 1 nuk do të interpretohen në kuptimin që i imponojnë njërit prej Shteteve Kontraktuese detyrimin:

a) të zbatojë masa administrative në ndryshim me ligjet dhe praktikat administrative të atij shteti apo të Shtetit tjetër Kontraktues;

b) të japë informacione që ndalohen sipas ligjeve ose praktikës normale administrative të atij shteti apo të Shtetit tjetër Kontraktues;

c) të japë informacione që mund të nxirrin një sekret tregtar, biznesi, industrial, komercial ose sekret profesional apo proces tregtar, ose informacione, komunikimi i të cilave do të ishte në kundërshtim me politikën publike (rendin publik).

Neni 27

Anëtarët e misioneve diplomatike dhe postave konsullore

Dispozitat e kësaj Marrëveshjeje nuk cenojnë privilegjet fiskale të anëtarëve të misioneve diplomatike ose postave konsullore që rrjedhin nga rregullat e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare apo nga dispozita të marrëveshjeve të veçanta.

Neni 28

Hyrja në fuqi

1. Kjo Marrëveshje do të ratifikohet dhe instrumentet e ratifikimit do të shkëmbehen sa më shpejt të jetë e mundur.

2. Marrëveshja do të hyjë në fuqi në ditën e parë të muajt të tretë që pason muajin në të cilin janë shkëmbyer instrumentet e ratifikimit dhe dispozitat e saj do të kenë efekt në lidhje me tatimet për çdo vit fiskal, duke filluar pas datës 31 dhjetor të vitit kalendarik në të cilin ka ndodhur shkëmbimi i instrumenteve të ratifikimit.

Neni 29

Përfundimi

Kjo Marrëveshje do të mbetet në fuqi deri në përfundimin nga njëri Shtet Kontraktues. Secili Shtet Kontraktues mund të përfundojë Marrëveshjen nëpërmjet kanaleve diplomatike, duke i dhënë Shtetit tjetër Kontraktues njoftimin me shkrim të përfundimit të kësaj Konvente, në ose para ditës së tridhjetë të muajt qershor të vitit kalendarik që pason vitin e pestë, duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të Marrëveshjes. Në këtë rast, Konventa nuk do të ketë efekt në lidhje me tatimet për çdo vit fiskal që fillon pas datës 31 dhjetor të vitit kalendarik në të cilin është dhënë njoftimi për përfundimin e Marrëveshjes.

Në dëshmi sa më sipër, përfaqësuesit fuqiptotë të dy Shteteve Kontraktuese, të autorizuar për këtë qëllim, kanë nënshkruar këtë Marrëveshje.

Bërë në dy kopje, në Tiranë, më 14 dhjetor 2007, në gjuhën shqipe, gjermane dhe angleze, duke qenë secili nga tekstet njëlloj autentik. Në rastin e mosmarrëveshjeve në interpretim, do të ketë përparësi teksti në gjuhën angleze.

PROTOKOLL

Në momentin e nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje, për eliminimin e tatimit të dyfishtë në lidhje me tatimet mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin dhe për parandalimin e evazionit fiskal, e përfunduar në këtë ditë ndërmjet Republikës së Austrisë dhe Republikës së Shqipërisë, të nënshkruarit kanë rënë dakord që dispozitat e mëposhtme do të jenë pjesë përbërëse e Marrëveshjes.

1. Në lidhje me nenin 11:

Nënkuptohet që përjashtimi i parashikuar në nënparagrafin “b” të paragrafit 3 të nenit 11 do të zbatohet vetëm në lidhje me interesat mbi huatë ose kreditë e marra në një Shtet Kontraktues dhe që i janë paguar një rezidenti të një Shteti tjetër Kontraktues, në rastin kur këto interesa lidhen me transaksionet e eksportit midis dy shteteve.

2. Në lidhje me nenin 12:

Sipas nenit 12, pagesat e marra në lidhje me shërbimet teknike, duke përfshirë studimet ose vëzhgimet e një natyre shkencore, gjeologjike ose teknike, ose në lidhje me kontratat inxhinierike, duke përfshirë hartimin e planimetrive të lidhura me to, ose në lidhje me shërbimet e mbikëqyrjes ose të konsulencës; nuk do të konsiderohen si pagesa të marra si shpërblim për informacionin e dhënë në lidhje me përvojën industriale, tregtare ose shkencore.

Gjithashtu nënkuptohet që, për qëllime të dallimit midis shpërblimit për shërbimet e përcaktuara në nenin 7 dhe të atij për shërbimet e ekspertizës, të përcaktuara në nenin 12 të Marrëveshjes, kostot e lidhura me to (kostot e pagave, të udhëtimit, të zyrave mbështetëse dhe të tjera të lidhura me to), do të merren parasysh.

Kjo nënkupton që në rastet kur shpërblimi kompenson kryesisht kosto të tilla (duke marrë në konsideratë dhe një marzh të përshtatshëm fitimi), një shpërblim i tillë nuk do të konsiderohet honorar. Megjithatë, në rastet kur kosto të tilla janë shumë më të ulta se shpërblimi total, një shpërblim i tillë do të konsiderohet honorar.

3. Në lidhje me nenin 16:

Nënkuptohet që çdo shpërblim i marrë nga një anëtar i bordit të drejtorëve në bazë të një kontrate punësimi ose shërbimi, në pozicionin e një menaxheri, konsulenti ose këshilltari, nuk do të mbulohet nga dispozitat e nenit 16.

4. Në lidhje me paragrafin 3 të nenit 7:

Nënkuptohet që paragrafi 3 do të zbatohet edhe ndaj enteve ligjore të cilat kryejnë aktivitete, si orkestra, teatër, grupe baleti, si dhe anëtarëve të këtyre enteve kulturore, në rast se ente të tilla janë kryesisht jofitimprurëse dhe në rast se ky kusht vërtetohet nga autoriteti kompetent i shtetit të rezidencës.

5. Interpretimi i Marrëveshjes

Nënkuptohet që dispozitat e Konventës, të cilat janë hartuar në përputhje me dispozitat përkatëse të Konventës së modelit OECD mbi të ardhurat dhe kapitalin, do të pritet që përgjithësisht të kenë të njëjtin kuptim si ai i shprehur në komentarin përkatës të OECD-së.

Kuptimi i paragrafit të mësipërm nuk do të zbatohet në rastet e:

a) çdo rezerve ose vëzhgimi të paraqitur ndaj Modelit të OECD-së ose komentarit përkatës nga secili prej Shteteve Kontraktuese;

b) çdo interpretimi që është në kundërshtim me këtë protokoll;

c) çdo interpretimi të ndryshëm, të publikuar si shpjegues nga njëri prej Shteteve Kontraktuese, i cili i është vënë në dispozicion autoritetit kompetent të Shtetit tjetër Kontraktues para hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje;

d) çdo interpretimi të ndryshëm, të miratuar në marrëveshje ndërmjet autoriteteve kompetente, pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

Komentari i OECD-së, meqë mund të jetë objekt i rishikimeve të vazhdueshme, përbën një mjet interpretimi në kuptimin e Marrëveshjes së Vjenës të datës 23 maj 1969 mbi ligjin e traktateve.

Në dëshmi sa më sipër, përfaqësuesit fuqiplotë të Shteteve Kontraktuese, të autorizuar për këtë qëllim, kanë nënshkruar këtë protokoll.

Bërë në dy kopje, në Tiranë, më 14 dhjetor 2007, në gjuhën shqipe, gjermane dhe angleze, duke qenë secili nga tekstet njëjloj autentik. Në rastin e mosmarrëveshjeve në interpretim, do të ketë përparësi teksti në gjuhën angleze.

LIGJ

Nr.9887, datë 10.3.2008

PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti

Ky ligj ka për objekt përcaktimin e rregullave për mbrojtjen dhe përpunimin e ligjshëm të të dhënave personale.

Neni 2
Parim i përgjithshëm

Përpunimi i ligjshëm i të dhënave personale bëhet duke respektuar dhe garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe, në veçanti, të drejtën e ruajtjes së jetës private.

Neni 3
Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Të dhëna personale” është çdo informacion për një person fizik, i cili është i identifikuar ose i identifikueshëm. Elementet, me të cilat realizohet identifikimi i një personi, drejtpërdrejt apo tërthorazi, janë numrat e identitetit ose faktorë të tjerë të veçantë fizikë, psikologjikë, ekonomikë, socialë, kulturorë etj.

2. “Të dhëna sensitive” është çdo informacion për personin fizik, që ka të bëjë me origjinën e tij racore ose etnike, mendimet politike, anëtarësimin në sindikata, besimin fetar apo filozofik, dënimin penal, si dhe të dhëna për shëndetin dhe jetën seksuale.

3. “Kontrollues” është çdo person fizik ose juridik, autoritet publik, agjenci apo njësi tjetër, të cilët, vetëm apo në bashkëpunim me të tjerë, mbajnë, përpunojnë, administrojnë, arkivojnë dhe për këtë shkak kontrollojnë të dhëna personale.

4. “Subjekti i të dhënave personale” është çdo person fizik, të cilit i përpunohen të dhënat personale.

5. “Përpunues” është çdo person fizik ose juridik, autoritet publik, agjenci ose çdo njësi tjetër, përveç punonjësve të kontrolluesit, që përpunojnë të dhëna për vetë kontrolluesin.

6. “Sistem arkivimi” është grup i strukturuar të dhënash personale, të aksesueshme sipas, të paktën, një kriteri specifik.

7. “Përpunimi i të dhënave” është çdo veprim që kryhet plotësisht ose jo me mjete automatike, me të dhënat personale, si grumbullimi, regjistrimi, ruajtja, renditja, përshtatja, ndreqja, këshillimi, shfrytëzimi, përdorimi, bllokimi, fshirja ose shkatërrimi apo çfarëdo veprim tjetër, si dhe transmetimi i të dhënave.

8. “Marrës” është çdo person fizik ose juridik, autoritet publik, agjenci apo njësi tjetër, të cilëve u jepen të dhëna personale.

9. “Transmetim” është transferimi i të dhënave personale te marrësit.

10. “Transferim ndërkombëtar” është dhënia e të dhënave personale marrësve në shtetet e huaja.

11. “Përhapje” është komunikimi i të dhënave personale ndërmjet kontrolluesve apo komunikimi i të dhënave personale te çdo person tjetër, përveç përpunuesit apo subjektit të të dhënave personale, përfshirë edhe publikimin.

12. “Pëlqim” është deklarata specifike, e dhënë me vullnet të lirë nga subjekti i të dhënave personale për përpunimin e të dhënave të tij.

Neni 4
Fusha e zbatimit

1. Ky ligj zbatohet për përpunimin e të dhënave personale, plotësisht ose pjesërisht, nëpërmjet mjeteve automatike, si dhe për përpunimin me mjete të tjera të të dhënave personale, që mbahen në një sistem arkivimi.

2. Ky ligj zbatohet për përpunimin e të dhënave personale nga:

a) kontrollues të vendosur në Republikën e Shqipërisë;

b) misionet diplomatike ose zyrat konsullore të shtetit shqiptar;

c) kontrollues, të cilët nuk janë të vendosur në Republikën e Shqipërisë, por që e ushtrojnë veprimtarinë nëpërmjet përdorimit të çdo mjeti, që ndodhet në Republikën e Shqipërisë.

3. Në rastet e parashikuara në shkronjën “c” të pikës 2 të këtij neni, kontrolluesi cakton një përfaqësues, i cili duhet të jetë i vendosur në Republikën e Shqipërisë. Parashikimet e këtij ligji, që zbatohen nga kontrolluesit, zbatohen edhe për përfaqësuesit e tyre.

4. Ky ligj nuk zbatohet për përpunimin e të dhënave nga një person fizik për qëllime tjeshit personale apo familjare.

KREU II PËRPUNIMI I TË DHËNAVE PERSONALE

Neni 5

Mbrojtja e të dhënave personale

1. Mbrojtja e të dhënave personale bazohet:
 - a) në përpunimin në mënyrë të ndershme, të drejtë dhe të ligjshme;
 - b) në grumbullimin për qëllime specifike, të përcaktuara qartë, e legjitime dhe në përpunimin në përputhje me këto qëllime;
 - c) të dhënat duhet të jenë të mjaftueshme, të lidhen me qëllimin e përpunimit dhe të mos e tejkalojnë këtë qëllim;
 - ç) në saktësinë nga ana faktike dhe, kur është e nevojshme, përditësimin e kryerjen e çdo veprimi për të siguruar që të dhënat e pasakta e të parregullta të fshihen apo të ndryshohen;
 - d) në mbajtjen në atë formë, që të lejojë identifikimin e subjekteve të të dhënave për një kohë, por jo më tepër sesa është e nevojshme për qëllimin, për të cilin ato janë grumbulluar ose përpunuar më tej.
2. Kontrolluesi është përgjegjës për zbatimin e këtyre kërkesave në të gjitha përpunimet automatike ose me mjete të tjera të të dhënave.

Neni 6

Kriteret ligjore për përpunimin

1. Të dhënat personale përpunohen vetëm:
 - a) nëse subjekti i të dhënave personale ka dhënë pëlqimin;
 - b) për hartimin dhe përmbushjen e kontratave, në të cilat subjekti i të dhënave personale është palë;
 - c) për të mbrojtur interesat jetikë të subjektit të të dhënave;
 - ç) për përmbushjen e një detyrimi ligjor të kontrolluesit;
 - d) për kryerjen e një detyre ligjore me interes publik ose ushtrimin e një kompetence të kontrolluesit ose të një pale të tretë, së cilës i janë përhapur të dhënat;
 - dh) për ndjekjen e interesave legjitimë të kontrolluesit ose të një pale të tretë, së cilës i janë përhapur të dhënat, përveç kur këta interesa mbizotërojnë mbi interesat për mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive themelore të subjektit të të dhënave.
2. Përpunimi i të dhënave personale, të përcaktuara në kuadër të veprimtarive të parandalimit dhe ndjekjes penale, për kryerjen e një vepre penale kundër rendit publik dhe të veprave të tjera në fushën e të drejtës penale, si dhe në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë kombëtare, kryhet nga autoritetet zyrtare të përcaktuara në ligj.

Neni 7

Përpunimi i të dhënave sensitive

1. Me përjashtim të rasteve të parashikuara në pikat 2 dhe 3 të këtij neni, ndalohet përpunimi i të dhënave, që zbulojnë origjinën racore ose etnike, mendimet politike, anëtarësinë në sindikata, besimin fetar apo filozofik, dënimet penale, si dhe shëndetin dhe jetën seksuale.
2. Përpunimi i të dhënave sensitive bëhet vetëm nëse:
 - a) subjekti i të dhënave ka dhënë pëlqimin, që mund të revokohet në çdo çast dhe e bën të paligjshëm përpunimin e mëtejshëm të të dhënave;
 - b) është në interesin jetik të subjektit të të dhënave ose të një personi tjetër dhe subjekti i të dhënave është fizikisht ose mendërisht i paaftë për të dhënë pëlqimin e vet;
 - c) autorizohet nga autoriteti përgjegjës për një interes të rëndësishëm publik;

ç) lidhet me të dhëna, që janë bërë haptazi publike nga subjekti i të dhënave ose është i nevojshëm për ushtrimin apo mbrojtjen e një të drejte ligjore;

d) të dhënat përpunohen për kërkime shkencore ose statistikore;

dh) të dhënat kërkohen për qëllime të mjekësisë parandaluese, diagnostikimit mjekësor, sigurimit të kujdesit shëndetësor, kurimit, menaxhimit të shërbimeve të kujdesit shëndetësor dhe përdorimi i tyre kryhet nga personeli mjekësor ose persona të tjerë, që kanë detyrimin për ruajtjen e fshehtësisë;

e) të dhënat përpunohen nga organizatat jofitimprurëse politike, filozofike, fetare ose sindikaliste, për qëllime të veprimtarisë të tyre të ligjshme, vetëm për anëtarët, sponsorizuesit ose personat e tjerë, që kanë lidhje me veprimtarinë e tyre. Këto të dhëna nuk u bëhen të ditura një pale të tretë, pa pëlqimin e subjektit të të dhënave, përveç kur parashikohet ndryshe në ligj;

ë) përpunimi është i nevojshëm për përmbushjen e detyrimit ligjor dhe të të drejtave specifike të kontrolluesit në fushën e punësimit, në përputhje me Kodin e Punës.

3. Përpunimi i të dhënave sensitive, në rrethana të tjera nga ato të përcaktuara në pikën 2 të këtij neni, rregullohet me vendim të Këshillit të Ministrave, vetëm për qëllime të interesave të rëndësishëm publikë, nën masa të përshtatshme mbrojtëse.

Neni 8

Transferimi ndërkombëtar

1. Transferimi ndërkombëtar i të dhënave personale kryhet, me marrës, nga shtete me një nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale. Niveli i mbrojtjes së të dhënave personale për një shtet përcaktohet duke vlerësuar të gjitha rrethanat lidhur me përpunimin, natyrën, qëllimin dhe kohëzgjatjen e tij, shtetin e origjinës dhe destinacionin përfundimtar, aktet ligjore dhe standardet e sigurisë në fuqi në shtetin marrës. Shtetet, që kanë nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Transferimi ndërkombëtar i të dhënave personale me një shtet, që nuk ka nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale mund të bëhet nëse:

a) autorizohet nga akte ndërkombëtare, të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe që janë të zbatueshme në mënyrë të drejtpërdrejtë;

b) subjekti i të dhënave ka dhënë pëlqimin për transferim ndërkombëtar;

c) përbën detyrim për përmbushjen e një kontrate të përfunduar ndërmjet kontrolluesit dhe subjektit të të dhënave ose një pale të tretë, në interesin e subjektit të të dhënave;

ç) është detyrim ligjor i kontrolluesit;

d) është i nevojshëm për mbrojtjen e interesave jetësorë të subjektit të të dhënave;

dh) është i nevojshëm apo përbën një kërkesë ligjore për një interes të rëndësishëm publik ose për ushtrimin dhe mbrojtjen e një të drejte ligjore;

e) është bërë nga një regjistër, i cili është i hapur për këshillime dhe siguron informacion për publikun në përgjithësi.

3. Shkëmbimi i të dhënave personale me përfaqësitë diplomatike të qeverive të huaja ose institucionet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë vlerësohet transferim ndërkombëtar.

Neni 9

Transferimi ndërkombëtar i të dhënave që duhet të autorizohen

1. Transferimi ndërkombëtar i të dhënave personale me një shtet, që nuk ka nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave, në raste të tjera nga ato të parashikuara në nenin 8 të këtij ligji, bëhet me autorizim të komisionerit.

2. Komisioneri, pasi bën vlerësimin, mund të japë autorizimin për transferimin e të dhënave personale në shtetin marrës, duke përcaktuar kushte dhe detyrime.

3. Komisioneri nxjerr udhëzime për lejimin e disa kategorive të transferimeve ndërkombëtare të të dhënave personale në një shtet që nuk ka nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale. Në këto raste, kontrolluesi përjashtohet nga kërkesa për autorizim.

4. Kontrolluesi, përpara transferimit të të dhënave, bën kërkesë për autorizim te komisioneri. Në kërkesë kontrolluesi duhet të garantojë respektimin e interesave për ruajtjen e sekretit të subjektit të të dhënave jashtë Republikës së Shqipërisë.

KREU III
PËRPUNIMI I VEÇANTË I TË DHËNAVE

Neni 10

Përpunimi për kërkime shkencore dhe statistikore

1. Të dhënat personale, të mbledhura për çfarëdolloj qëllimi, mund të përpunohen më tej për qëllime shkencore ose statistikore, duke siguruar se nuk janë përpunuar, për të marrë masa ose vendime për një individ.

2. Transmetimi i të dhënave sensitive për kërkimet shkencore bëhet vetëm kur ekziston një interes i rëndësishëm publik. Të dhënat personale përdoren vetëm nga persona, të cilët janë të detyruar të ruajnë konfidencialitetin.

3. Në rastet kur përdorimi i të dhënave bëhet në një formë, që lejon identifikimin e subjektit të të dhënave, të dhënat duhet të kodohen menjëherë, në mënyrë që subjektet të mos jenë më të identifikueshme. Të dhënat personale të koduara përdoren vetëm nga persona, të cilët janë të detyruar të ruajnë konfidencialitetin.

Neni 11

Përpunimi për qëllime të tjera

Përpunimi i të dhënave personale vetëm për qëllime gazetarie, literature ose artistike përjashtohet nga zbatimi i neneve 5, 6, 7, 8, 12, 18, 21 e 28 të këtij ligji, vetëm nëse mbrojtja e të dhënave personale, sipas këtyre dispozitave, pengon ushtrimin e së drejtës së lirisë së shprehjes.

KREU IV
TË DREJTAT E SUBJEKTIT TË TË DHËNAVE

Neni 12

E drejta për akses

1. Çdo person ka të drejtë që, me kërkesë me shkrim, të marrë nga kontrolluesi:

a) konfirmimin nëse të dhënat personale po i përpunohen ose jo, informacion për qëllimin e përpunimit, për kategoritë e të dhënave të përpunuara dhe për marrësit e kategoritë e marrësve, të cilëve u përhapen të dhënat personale;

b) në një formë të kuptueshme, të dhënat personale dhe informacionin e disponueshëm për burimin e tyre;

c) në rastet e vendimeve automatike, sipas nenit 14 të këtij ligji, informacion për logjikën e përfshirë në vendimmarrje.

Informacioni për të dhënat komunikohet në formën, në të cilën ishin në kohën kur është bërë kërkesa.

2. Kontrolluesi, brenda 30 ditëve nga data e marrjes së kërkesës, informon subjektin e të dhënave ose i shpjegon atij arsyet e mosdhënies së informacionit.

3. E drejta për akses, sipas pikës 1 të këtij neni, ushtrohet në përputhje me parimet kushtetuese të lirisë së shprehjes dhe informacionit, lirisë së shtypit dhe sekretit profesional dhe mund të kufizohet, nëse cenon interesat e sigurisë kombëtare, politikën e jashtme, interesat ekonomikë dhe financiarë të shtetit, parandalimin dhe ndjekjen e veprave penale.

4. E drejta e aksesit nuk mund të ushtrohet në rastet e parashikuara në pikën 1 të nenit 10 të këtij ligji.

5. Në rast se aksesit mohohet, duke argumentuar se cenohen interesat e sigurisë kombëtare, politika e jashtme, interesat ekonomikë dhe financiarë të shtetit, parandalimi dhe ndjekja e veprave penale ose liria e shprehjes dhe informimit apo liria e shtypit, subjekti i të dhënave mund t'i kërkojë komisionerit të kontrollojë përjashtimin në rastin konkret. Komisioneri informon subjektin e të dhënave për masat e marra.

Neni 13

E drejta për të kërkuar korrigjimin ose fshirjen

1. Çdo subjekt i të dhënave ka të drejtë të kërkojë korrigjimin ose fshirjen e të dhënave, kur vihet në dijeni se të dhënat rreth tij nuk janë të rregullta, të vërteta, të plota ose janë përpunuar dhe mbledhur në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji.

2. Kontrolluesi, brenda 30 ditëve nga data e marrjes së kërkesës së subjektit të të dhënave, duhet ta informojë atë për përpunimin e ligjshëm të të dhënave, kryerjen ose moskryerjen e korrigjimit apo të fshirjes.

3. Kur kontrolluesi nuk bën korrigjimin ose fshirjen e të dhënave të kërkuara prej tij, subjekti i të dhënave ka të drejtë të ankohet te komisioneri.

Neni 14

Vendimmarrja automatike

1. Çdo person ka të drejtë të mos jetë subjekt i vendimeve, të cilat shkaktojnë efekte ligjore për të ose ndikojnë në mënyrë të rëndësishme tek ai dhe kur vendimi është bazuar vetëm në përpunimin automatik të të dhënave, që synojnë të vlerësojnë disa aspekte personale, që lidhen me të, veçanërisht, efektivitetin në punë, besueshmërinë ose sjelljen.

2. Një person mund të jetë subjekt i një vendimi të marrë, sipas pikës 1 të këtij neni, kur merren masa për të mbrojtur interesat e tij të ligjshëm, veçanërisht duke përfshirë në vendim këndvështrimet e tij.

Neni 15

E drejta e subjektit të të dhënave për të kundërshtuar

1. Subjekti i të dhënave ka të drejtë të kundërshtojë, në çdo kohë, mbështetur në ligj, përpunimin e të dhënave rreth tij, sipas shkronjave “d” dhe “dh” të nenit 6 të këtij ligji, përveç kur parashikohet ndryshe me ligj.

2. Subjekti i të dhënave ka të drejtë t'i kërkojë kontrolluesit të mos fillojë ose, nëse përpunimi ka filluar, të ndalojë përpunimin e të dhënave personale, që lidhen me të, për qëllime të tregtimit të drejtpërdrejtë.

Neni 16

E drejta për t'u ankuar

1. Çdo person, që pretendon se i janë shkelur të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshëm për të dhënat personale, ka të drejtë të ankohet ose të njoftojë komisionerin dhe të kërkojë ndërhyrjen e tij për vënien në vend të së drejtës së shkelur. Pas këtij ankimi, në përputhje me Kodin e Procedurës Civile, subjekti i të dhënave mund të ankohet në gjykatë.

2. Në rast se subjekti i të dhënave ka bërë ankim, kontrolluesi nuk ka të drejtë të ndryshojë të dhënat personale deri në dhënien e vendimit përfundimtar.

Neni 17

Kompensimi i dëmit

Çdo person, të cilit i është shkaktuar një dëm, si rezultat i përpunimit të paligjshëm të të dhënave personale, ka të drejtë t'i kërkojë kompensim kontrolluesit për dëmin e shkaktuar.

KREU V
DETYRIMET E KONTROLLUESIT DHE TË PËRPUNUESIT

Neni 18
Detyrimi për informim

1. Kontrolluesi, kur mbledh të dhëna personale, duhet ta informojë subjektin e këtyre të dhënave. Në këtë informacion duhet të përcaktohen kategoritë e të dhënave personale, që do të përpunohen, qëllimi i përpunimit, emri dhe adresa e kontrolluesit dhe çdo informacion tjetër, i nevojshëm, për të garantuar përpunimin e drejtë të të dhënave personale. Ky informacion nuk jepet, nëse subjekti i të dhënave ka dijeni për të.

2. Të dhënat mund të mblidhen nëpërmjet transmetimit nga një përpunim tjetër, i kryer nga i njëjti kontrollues ose kontrollues të tjerë. Në këto raste, informacioni nuk do të jepet, kur përpunimi i të dhënave është parashikuar nga ligji, kur është e pamundur dhënia e informacionit, për shkak se nuk mund të gjendet subjekti i të dhënave, ose kur të dhënat përpunohen sipas pikës 1 të nenit 10 të këtij ligji.

Neni 19
Detyrimi për korrigjim ose fshirje

1. Kontrolluesi kryen vetë ose me kërkesë të subjektit të të dhënave korrigjimin ose fshirjen e të dhënave personale, kur vëren se janë të parregullta, të pavërteta, të paplota ose janë përpunuar në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji.

2. Kontrolluesi, brenda 30 ditëve nga marrja e kërkesës së subjektit të të dhënave, informon subjektin e të dhënave për kryerjen apo moskryerjen e korrigjimit ose të fshirjes.

3. Kontrolluesi informon marrësin e të dhënave personale për korrigjimin ose fshirjen e të dhënave personale, të transmetuara para korrigjimit apo fshirjes.

Neni 20
Detyrimet e përpunuesit

1. Kontrolluesit, për përpunimin e të dhënave personale, mund të punësojnë përpunues, të cilët garantojnë përdorimin e ligjshëm dhe të sigurt të të dhënave. Çdo përpunues i të dhënave personale ka këto detyrime:

a) të përpunojë të dhënat vetëm në përputhje me udhëzimet e kontrolluesit; të mos i transmetojë ato, përveç kur ka marrë udhëzim nga kontrolluesi;

b) të marrë të gjitha masat e sigurisë, sipas këtij ligji dhe të punësojë operatorë, të cilët kanë detyrimin për ruajtjen e fshehtësisë;

c) të krijojë, në marrëveshje me kontrolluesin, kushtet e nevojshme teknike dhe organizative për përmbushjen e detyrimeve të kontrolluesit, për të siguruar të drejtat e subjekteve të të dhënave personale;

ç) t'i dorëzojë kontrolluesit, pas përfundimit të shërbimit të përpunimit, të gjitha rezultatet e përpunimit dhe dokumentacionit, që përmban të dhëna ose t'i mbajë apo t'i shkatërrojë ato me kërkesë të kontrolluesit;

d) të vërë në dispozicion të kontrolluesit të gjithë informacionin e nevojshëm, për të kontrolluar përputhshmërinë me detyrimet, që rrjedhin sipas shkronjave të mësipërme.

2. Detyrimet e pikës 1 përcaktohen në kontratën e kontrolluesit me përpunuesin.

KREU VI
NJOFTIMI

Neni 21
Përgjegjësia për të njoftuar

1. Çdo kontrollues duhet të njoftojë komisionerin për përpunimin e të dhënave personale, për të cilat është përgjegjës.

Njoftimi duhet të bëhet para se kontrolluesi të përpunojë të dhënat për herë të parë ose kur kërkohet ndryshimi i qëllimit të përpunimit, të njoftuar më parë.

2. Përfshihet nga detyrimi për të njoftuar përpunimi i të dhënave personale, me qëllim mbajtjen e një regjistri, i cili, në përputhje me ligjin ose aktet nënligjore, siguron informacion për publikun në përgjithësi.

3. Përfshihet nga detyrimi për të njoftuar të dhënat personale që përpunohen, me qëllim mbrojtjen e institucioneve kushtetuese, të interesave të sigurisë kombëtare, politikës së jashtme, interesave ekonomikë ose financiarë të shtetit, apo për parandalimin e ndjekjen e veprave penale.

4. Rastet e tjera, për të cilat njoftimi nuk është i nevojshëm, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 22

Përmbajtja e njoftimit

Njoftimi duhet të përmbajë:

- a) emrin dhe adresën e kontrolluesit;
- b) qëllimin e përpunimit të të dhënave personale;
- c) kategoritë e subjekteve të të dhënave dhe kategoritë e të dhënave personale;
- ç) marrësit dhe kategoritë e marrësve të të dhënave personale;
- d) propozimin për transferimet ndërkombëtare që kontrolluesi synon të kryejë;
- dh) një përshkrim të përgjithshëm të masave për sigurinë e të dhënave personale.

Neni 23

Procedura e shqyrtimit

Komisioneri shqyrton të gjitha njoftimet dhe kur njoftimi është i pamjaftueshëm, ai urdhëron kontrolluesin të plotësojë të dhënat, duke përcaktuar edhe afatin kohor.

Neni 24

Kontrolli paraprak

1. Autorizimi i komisionerit kërkohet për:

- a) përpunimin e të dhënave sensitive, sipas shkronjës “c” të pikës 2 të nenit 7 të këtij ligji;
- b) përpunimin e të dhënave personale, sipas pikës 1 të nenit 9 të këtij ligji.

2. Nëse përpunimi i të dhënave, sipas pikës 1 të këtij neni, autorizohet nga një dispozitë ligjore, nuk kërkohet autorizim nga komisioneri.

Neni 25

Fillimi i përpunimit

1. Përpunimi i të dhënave fillon pas njoftimit.

2. Përpunimi i të dhënave, për të cilat kërkohet autorizim, sipas pikës 1 të nenit 24 të këtij ligji, mund të fillojë vetëm pas marrjes së autorizimit.

Neni 26

Publikimi i përpunimeve

1. Për të dhënat që kërkohet autorizim, merret vendim i veçantë dhe pasqyrohet në regjistrin që administrohet nga komisioneri, i cili është i hapur për njohje për çdo person.

2. Regjistrimi duhet të përmbajë informacionin, sipas nenit 22 të këtij ligji, përveç informacionit të përcaktuar në shkronjën “dh” të nenit 22 të këtij ligji, i cili nuk publikohet.

3. Kontrolluesi i përfshirë nga detyrimi për njoftim duhet të bëjë të disponueshme, të paktën, të dhënat për emrin dhe adresën, kategoritë e të dhënave personale të përpunuara, qëllimet e përpunimeve, kategoritë e marrësve, të cilëve u përhapen të dhënat personale, në një formë të përshtatshme të çdo person, sipas kërkesës së tij.

4. Ky nen nuk zbatohet për përpunime për mbajtjen e një regjistri, i cili, në përputhje me ligjin apo aktet nënligjore, siguron informacion për publikun në përgjithësi.

KREU VII SIGURIA E TË DHËNAVE PERSONALE

Neni 27

Masat për sigurinë e të dhënave personale

1. Kontrolluesi ose përpunuesi merr masa organizative dhe teknike të përshtatshme për të mbrojtur të dhënat personale nga shkatërrime të paligjshme, aksidentale, humbje aksidentale, për të mbrojtur aksesin ose përhapjen nga persona të paautorizuar, veçanërisht kur përpunimi i të dhënave bëhet në rrjet, si dhe nga çdo formë tjetër e paligjshme përpunimi.

2. Kontrolluesi merr këto masa të veçanta sigurie:

a) përcakton funksionet ndërmjet njësive organizative dhe operatorëve për përdorimin e të dhënave;

b) përdorimi i të dhënave bëhet me urdhër të njësive organizative ose të operatorëve të autorizuar;

c) udhëzon operatorët, pa përjashtim, për detyrimet që kanë, në përputhje me këtë ligj dhe rregulloret e brendshme për mbrojtjen e të dhënave, përfshirë edhe rregulloret për sigurinë e të dhënave;

ç) ndalon hyrjen në mjediset e kontrolluesit ose të përpunuesit të të dhënave të personave të paautorizuar;

d) hyrja në të dhënat dhe programet bëhet vetëm nga personat e autorizuar,

dh) ndalon hyrjen në mjetet e arkivimit dhe përdorimin e tyre nga persona të paautorizuar;

e) vënia në punë e pajisjeve të përpunimit të të dhënave bëhet vetëm me autorizim dhe çdo mjet sigurohet me masa parandaluese ndaj vënies së autorizuar në punë;

ë) regjistron dhe dokumenton modifikimet, korrigjimet, fshirjet, transmetimet etj.

3. Të dhënat e dokumentuara nuk përdoren për qëllime të tjera, që nuk janë në përputhje me qëllimin e grumbullimit. Ndalohet njohja ose çdo përpunim i të dhënave të regjistruara në dosje për një qëllim të ndryshëm nga e drejta për të hedhur të dhëna. Përfshihet nga ky rregull rasti kur të dhënat përdoren për parandalimin ose ndjekjen e një vepre penale.

4. Dokumentacioni i të dhënave mbahet për aq kohë sa është i nevojshëm për qëllimin, për të cilin është grumbulluar.

5. Niveli i sigurisë duhet të jetë i përshtatshëm me natyrën e përpunimit të të dhënave personale. Rregulla të hollësishme për sigurimin e të dhënave përcaktohen me vendim të komisionerit.

6. Procedurat e administrimit të regjistrimit të të dhënave, të hedhjes së të dhënave, të përpunimit dhe nxjerrjes së tyre përcaktohen me vendim të komisionerit.

Neni 28

Konfidencialiteti i të dhënave

Kontrolluesit, përpunuesit dhe personat, që vihen në dijeni me të dhënat e përpunuara, gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, detyrohen të ruajnë konfidencialitetin dhe besueshmërinë edhe pas përfundimit të funksionit. Këto të dhëna nuk përhapen, përveç rasteve të parashikuara me ligj.

KREU VIII KOMISIONERI PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

Neni 29

Komisioneri

1. Komisioneri për mbrojtjen e të dhënave personale është autoriteti përgjegjës, që mbikëqyr dhe monitoron, në përputhje me ligjin, mbrojtjen e të dhënave personale, duke respektuar e garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.

2. Komisioneri është person juridik publik.
3. Informacioni i siguruar nga komisioneri, gjatë ushtrimit të detyrës, përdoret vetëm për qëllime mbikëqyrjeje, në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale. Komisioneri është i detyruar të ruajë konfidencialitetin e të dhënave edhe pas mbarimit të detyrës.

Neni 30
Të drejtat

1. Komisioneri ka këto të drejta:
 - a) kryen hetim administrativ dhe ka të drejtën e aksesit në përpunimet e të dhënave personale, si dhe ka të drejtë të mbledhë të gjithë informacionin e nevojshëm për përmbushjen e detyrave të mbikëqyrjes;
 - b) urdhëron bllokimin, fshirjen, shkatërrimin ose pezullon përpunimin e paligjshëm të të dhënave personale;
 - c) jep udhëzime përpara se përpunimet të kryhen dhe siguron publikimin e tyre.
2. Komisioneri, në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, vepron sipas nenit 39 të këtij ligji dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Neni 31
Përgjegjësitë

1. Komisioneri është përgjegjës për:
 - a) dhënien e mendimeve për aktet ligjore dhe nënligjore, që kanë të bëjnë me të dhënat personale;
 - b) dhënien e autorizimit, në raste të veçanta, për përdorimin e të dhënave personale për qëllime jo të përcaktuara në grumbullimin e tyre, duke respektuar parimet e nenit 5 të këtij ligji;
 - c) dhënien e autorizimit për transferimin ndërkombëtar të të dhënave personale, në përputhje me nenin 9 të këtij ligji;
 - ç) nxjerrjen e udhëzimeve, ku përcaktohet koha e mbajtjes së të dhënave personale, sipas qëllimit të tyre, në veprimtarinë e sektorëve të veçantë;
 - d) sigurimin e së drejtës së informimit dhe të ushtrimit të së drejtës së korrigjimit e të përditësimit të të dhënave;
 - dh) dhënien e autorizimit për përdorimin e të dhënave sensitive, në përputhje me shkronjën “c” të pikës 2 të nenit 7 të këtij ligji;
 - e) kontrollimin e përpunimit të të dhënave, në përputhje me ligjin, me kërkesë të një personi, kur një përpunim i tillë është i përjashtuar nga e drejta e informacionit dhe vënien në dijeni të personit se kontrolli është kryer, si dhe verifikimin nëse procesi është i ligjshëm ose jo;
 - ë) zgjidhjen e ankimeve të çdo personi për mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive të tij, për përpunimet e të dhënave personale dhe vënien e tij në dijeni për ecurinë;
 - f) nxjerrjen e udhëzimeve për marrjen e masave të sigurisë në veprimtarinë e sektorëve të veçantë;
 - g) kontrollin e zbatimit të gjobave;
 - gj) përgatitjen, në bashkëpunim, të kodeve të etikës;
 - h) publikimin dhe shpjegimin e të drejtave për mbrojtjen e të dhënave dhe publikimin periodikisht të veprimtarive të zhvilluara prej tij;
 - i) bashkëpunimin me autoritetet mbikëqyrëse për të dhënat personale të shteteve të huaja, për mbrojtjen e të drejtave të individëve rezidentë në këto shtete;
 - j) përfaqësimin e autoritetit mbikëqyrës në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale në veprimtaritë kombëtare dhe ndërkombëtare;
 - k) ushtrimin e detyrave të tjera ligjore.
2. Komisioneri krijon një regjistër për dokumentimin e të gjitha njoftimeve dhe autorizimeve, që ai kryen në ushtrim të kompetencave të tij, në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale.

3. Komisioneri paraqet raport vjetor përpara Kuvendit dhe raporton përpara tij sa herë i kërkohet. Gjithashtu, ai mund t'i kërkojë Kuvendit të dëgjohet për çështje që i çmon të rëndësishme.

Neni 32

Detyrimi për bashkëpunim

1. Institucionet publike dhe private bashkëpunojnë me komisionerin, duke i siguruar të gjithë informacionin që ai kërkon për përmbushjen e detyrave.

2. Komisioneri ka akses në sistemin e kompjuterave, në sistemet e arkivimit, që kryejnë përpunimin e të dhënave personale dhe në të gjithë dokumentacionin, që lidhet me përpunimin dhe transferimin e tyre, për ushtrimin e të drejtave dhe të detyrave që i janë ngarkuar me ligj.

Neni 33

Zgjedhja dhe qëndrimi në detyrë

Komisioneri zgjidhet nga Kuvendi, me propozimin e Këshillit të Ministrave, për një mandat 5-vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje.

Neni 34

Papajtueshmëria e funksionit

Funksioni i komisionerit është i papajtueshëm me çdo funksion tjetër shtetëror, me anëtarësimin në partitë politike dhe pjesëmarrjen në veprimtaritë e tyre, si dhe me çdo veprimtari tjetër fitimprurëse, me përjashtim të mësimdhënies.

Neni 35

Kriteret për t'u zgjedhur

Komisioner mund të zgjidhet shtetasi shqiptar, që plotëson kushtet e mëposhtme:

- a) ka arsim të lartë juridik;
- b) ka njohuri dhe veprimtari të shquara në fushën e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut;
- c) shquhet për aftësi profesionale dhe figurë të pastër etiko-morale;
- ç) ka vjetërsi pune në profesionin e juristit jo më pak se 10 vjet;
- d) nuk është dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;
- dh) nuk është larguar nga puna ose shërbimi civil me masë disiplinore.

Neni 36

Mbarimi i mandatit

1. Mandati i komisionerit mbaron para kohe kur:

- a) dënohet nga gjykata me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;
- b) nuk paraqitet pa arsye në detyrë për më shumë se 1 muaj;
- c) jep dorëheqjen;
- ç) deklarohet i paaftë me vendim gjykate të formës së prerë.

2. Komisioneri mund të shkarkohet nga Kuvendi:

- a) për shkelje të dispozitave të këtij ligji apo akteve të tjera ligjore;
- b) kur kryen veprimtari, që krijon konflikt interesash;
- c) kur zbulohen raste të papajtueshmërisë së funksionit të tij.

3. Në rast se vendi i komisionerit mbetet vakant, Këshilli i Ministrave, brenda 15 ditëve, i propozon Kuvendit kandidaturën e re. Kuvendi zgjedh komisionerin brenda 15 ditëve nga paraqitja e kandidaturës.

Neni 37
Zyra e komisionerit

Kuvendi vendos për pagën e komisionerit, strukturën organizative dhe klasifikimin e pagave për punonjësit e zyrës së komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale. Punonjësit e kësaj zyre gëzojnë statusin e nëpunësit civil.

Neni 38
Buxheti

Komisioneri ka buxhetin e vet të pavarur, i cili financohet nga Buxheti i Shtetit dhe nga donacione të ndryshme.

KREU IX
SANKSIONE ADMINISTRATIVE

Neni 39
Kundërvajtjet administrative

1. Rastet e përpunimit të të dhënave në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë, si më poshtë:

a) kontrolluesit, që përdorin të dhëna personale në kundërshtim me kreun II “Përpunimi i të dhënave personale”, dënohen me 10 000 deri në 50 000 lekë;

b) kontrolluesit, që nuk përmbushin detyrimin për të informuar, të përcaktuar në nenin 18 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 30 000 lekë;

c) kontrolluesit, që nuk përmbushin detyrimin për të korrigjuar ose fshirë të dhënat, të përcaktuar në nenin 19 të këtij ligji, dënohen me 15 000 deri në 30 000 lekë;

ç) përpunuesit, që nuk zbatojnë detyrimet e përcaktuara në nenin 20 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 30 000 lekë;

d) kontrolluesit, që nuk përmbushin detyrimin për të njoftuar, sipas përcaktimit në nenin 21 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 50 000 lekë;

dh) kontrolluesit ose përpunuesit, që nuk marrin masat e sigurisë së të dhënave, të përcaktuara në nenin 27 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 15 000 lekë.

2. Personat juridikë, për kundërvajtjet e mësipërme, dënohen me dyfishin e gjobës së përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

3. Maksimumi i gjobës dyfishohet në rastin kur veprohet në kundërshtim me pikën 2 të nenit 16 të këtij ligji dhe kur të dhënat përpunohen pa autorizim, sipas shkronjës “b” të pikës 1 të nenit 31 të këtij ligji.

4. Gjobat vendosen nga komisioneri, kur vërehet se janë shkelur detyrimet e përcaktuara në ligj.

Neni 40
Ankimi

Kundërvajtësi, brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për vënien e gjobës, mund të bëjë ankim në gjykatë, në përputhje me Kodin e Procedurës Civile.

Neni 41
Ekzekutimi i gjobave

1. Gjobat paguhen nga kundërvajtësi jo më vonë se 30 ditë nga komunikimi i tyre. Me kalimin e këtij afati, vendimi i dhënë shndërrohet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga zyra e përmbarimit, me kërkesë të komisionerit.

2. Gjobat arkëtohen në Buxhetin e Shtetit.

KREU X
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 42
Aktet nënligjore

Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 7, 8 e 21 të këtij ligji.

Neni 43
Shfuqizime

Ligji nr.8517, datë 22.7.1999 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, shfuqizohet.

Neni 44
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.5671, datë 21.3.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

LIGJ
Nr.9888, datë 10.3.2008

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR.8328,
DATË 16.4.1998 “PËR TË DREJTAT DHE TRAJTIMIN E TË DËNUARVE
ME BURGIM”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.8328, datë 16.4.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Titulli i ligjit ndryshohet si më poshtë:
“PËR TË DREJTAT DHE TRAJTIMIN E TË DËNUARVE ME BURGIM DHE TË
PARABURGOSURVE”.

Neni 2

Në fund të nenit 2 shtohen fjalët “si dhe të paraburgosurit.”.

Neni 3

Neni 3 shfuqizohet.

Neni 4

Në nenin 8, paragrafi i fundit shfuqizohet.

Neni 5

Në nenin 9 bëhen këto ndryshime:

- a) Titulli ndryshohet e bëhet “Rehabilitimi social”.
- b) Fjala “riedukimin” zëvendësohet me fjalët “rehabilitimin social”.

Neni 6

Në nenin 12 bëhen këto ndryshime:

- a) Pas fjalëve “Institute të veçanta” shtohen fjalët “Institucion paraburgimi”.
- b) Paragrafi i dytë ndryshohet si më poshtë:
“Krijimi, klasifikimi dhe mbyllja e institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale me burgim apo seksioneve të veçanta në këto institucione bëhen me urdhër të ministrit të Drejtësisë.”.

Neni 7

Në nenin 13, paragrafi i dytë shfuqizohet.

Neni 8

Neni 14 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 14

Burgu i sigurisë së zakonshme

Burgjet e sigurisë së zakonshme janë institucionet, ku vuhet dënimi nga të gjithë të dënuarit, me përjashtim të atyre, që vendosen në burgjet e sigurisë së lartë, në burgjet e sigurisë së ulët dhe në institucione të veçanta.

Kur gjykata, në vendimin me burgim, nuk është shprehur për llojin e institucionit, ku do të vuhet dënimi, të dënuarit vendosen në një burg të sigurisë së zakonshme. Shpërndarja dhe transferimi i të dënuarve në burgjet e sigurisë së zakonshme bëhen nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve.

Me urdhër të Ministrit të Drejtësisë, në burgjet e sigurisë së zakonshme mund të krijohen seksione të sigurisë së ulët.”.

Neni 9

Neni 15 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 15

Burgu i sigurisë së ulët

Burgjet e sigurisë së ulët janë institucionet, ku vuhet dënimi për të dënuarit për kundërvajtje penale, për vepra penale nga pakujdesia dhe për vepra të tjera penale, dënimi i të cilave nuk i kalon 5 vjet burgim.

Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve, me kërkesë të drejtorit të institucionit ku i dënuari po vuan dënimin, apo me nismën e vet, për të dënuarit që u ka mbetur për të vuajtur më pak se 2 vjet burgim dhe kanë respektuar rregulloren e brendshme të institucionit, mund të vendosë transferimin e tyre në një burg të sigurisë së ulët.”.

Neni 10

Pas nenit 15 shtohet neni 15/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 15/1

Institucionet e paraburgimit

Institucionet e paraburgimit janë institucionet, ku mbahen individët, ndaj të cilëve është dhënë nga gjykata masa e sigurimit “arrest në burg””.

Neni 11

Titulli i kreut II ndryshohet si më poshtë:
“ORGANET DREJTUESE TË BURGJEVE”.

Neni 12

Neni 19 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 19

Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve

Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve është organ qendror, në varësi të Ministrisë së Drejtësisë, e cila organizon, drejton dhe kontrollon të gjitha institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale.

Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve emërohet dhe shkarkohet nga Kryeministri, me propozimin e Ministrisë së Drejtësisë.”.

Neni 13

Neni 20 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 20

Institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale

Institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale janë institucione në varësi të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe kanë për detyrë pritjen, sistemimin, trajtimin dhe rehabilitimin social të të burgosurve.

Institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale drejtohen, kontrollohen dhe përfaqësohen nga drejtori, i cili emërohet dhe shkarkohet nga Ministri i Drejtësisë, me propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve.”.

Neni 14

Neni 23 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 23
Ndërtesat

Ndërtesat e institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale me burgim duhet të projektohen, të ndërtohen apo të rikonstruktohen, në mënyrë që të plotësojnë kërkesat për një jetë normale. Ato duhet të kenë hapësira të mjaftueshme për zhvillimin e veprimtarive të përbashkëta, si dhe të plotësojnë kërkesat individuale të të dënuarve apo të paraburgosurve.

Rregullat dhe kriteret e hollësishme për kushtet teknike, që duhet të plotësojnë ndërtesat e reja të institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale, përcaktohen me udhëzim të përbashkët të Ministrit të Drejtësisë, Ministrit të Shëndetësisë dhe të ministrit që mbulon fushën e ndërtimit.”.

Neni 15

Paragrafi i fundit i nenit 28 ndryshohet si më poshtë:

“Ajrimi në mjedise të hapura bëhet në grupe, përveç rasteve të parashikuara në nenin 53 shkronjat “c”, “ç” dhe “d”.”

Neni 16

Neni 29 shfuqizohet.

Neni 17

Neni 33 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 33
Shërbimi mjekësor

Shërbimi mjekësor sigurohet gjatë të gjithë kohës së qëndrimit në institucion, pavarësisht nga kërkesat e të dënuarve.

Administrata e institucionit siguron kushtet, mjetet dhe personelin për mbrojtjen e shëndetit të të dënuarve.

Organizimi dhe realizimi i shërbimit shëndetësor bëhen nga administrata e institucionit, në bashkëpunim me spitalin e burgjeve dhe me organet shtetërore përkatëse të shëndetësisë.

Të dënuarit mund të kërkojnë që të vizitohen, me shpenzimet e tyre, nga një mjek që duan ata.

Shërbimi shëndetësor duhet të sigurojë:

1. Diagnostikimin dhe mjekimin e sëmundjeve.

2. Furnizimin me ilaçe dhe pajisje mjekësore.

3. Profilaksinë për sëmundjet, duke bërë kujdes të veçantë për sëmundjet infektive dhe ato ngjitëse.

4. Sigurimin e higjienës së mjedisit dhe edukimin sanitar të të dënuarve.

Çdo institucion ka shërbim shëndetësor e farmaceutik, që i përgjigjet nevojave për parandalimin dhe ruajtjen e shëndetit të të dënuarve.

Të dënuarit, që dyshohen ose kanë sëmundje ngjitëse, izolohen menjëherë në mjedise të posaçme.

Në institucionet ku vuajnë dënimin gratë, funksionojnë shërbimet speciale në shërbim të grave shtatzëna dhe të atyre me fëmijë në gji. Personeli mjekësor viziton çdo ditë të dënuarit e sëmurë e ato që bëjnë kërkesë dhe kontrollon, periodikisht, të gjithë të dënuarit e tjerë, sipas një grafiku të hartuar nga drejtoria e institucionit. Personeli mjekësor evidenton dhe njofton menjëherë për sëmundjet që kërkojnë trajtim të specializuar.

Për rastet e sëmundjeve ngjitëse ose të sëmundjeve të tjera, diagnostikimi dhe mjekimi i të cilave nuk mund të sigurohen në kushtet e institucionit, të dënuarit transferohen në spitalin e burgjeve dhe, kur është e nevojshme, ata transferohen në Qendrën Spitalore Universitare, Tiranë e në institucionet spitalore, në rang qarku apo rrethi, në varësi të saj.

Diagnostikimi dhe mjekimi në këto qendra bëhen sipas një udhëzimi të përbashkët të Ministrit të Drejtësisë dhe të Ministrit të Shëndetësisë.

Në raste urgjence, kur rrezikohet jeta e të dënuarit, ai transferohet për mjekim në spitalin e burgjeve ose në spitalet rajonale.

Institutet rajonale higjieno-sanitare vizitojnë, të paktën dy herë në vit, institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale, për kontrollin e gjendjes higjieno-sanitare të mjediseve dhe masat e marra nga shërbimi shëndetësor i institucionit, për parandalimin e sëmundjeve infektive.”.

Neni 18

Në nenin 34 bëhen këto ndryshime:

- a) Titulli ndryshohet dhe bëhet “Punësimi”.
- b) Në fillim të paragrafit të parë shtohet fjalia me këtë përmbajtje: “Të gjithë të dënuarve u njihet e drejta për të punuar.”.

Neni 19

Në nenin 40, fjalia e fundit e paragrafit të katërt shfuqizohet.

Neni 20

Neni 43 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 43

Hyrja në institucion

Institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale mund të vizitohen pa autorizim nga:

Presidenti i Republikës, Kryetari i Kuvendit, Kryeministri, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, Zëvendëskryetari i Kuvendit, Zëvendëskryeministri, Ministri i Drejtësisë, Kryetari i Gjykatës së Lartë, Prokurori i Përgjithshëm, deputetët, Zëvendësministri i Drejtësisë, Avokati i Popullit, komisionerët dhe ndihmëskomisionerët e tij, Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve dhe zëvendësit e tij, Drejtori i Policisë së Burgjeve, drejtori dhe inspektorët e kontrollit të brendshëm të burgjeve, anëtarët e komisionit mbikëqyrës të ekzekutimit të vendimeve penale, gjyqtarët dhe prokurorët gjatë ushtrimit të detyrës së tyre, si dhe avokatët e të burgosurve dhe të paraburgosurve.

Nuk është i nevojshëm autorizimi për ata që shoqërojnë personat e përmendur në paragrafin e mësipërm, por gjithmonë jo më shumë se dy.

Personat e tjerë, që nuk parashikohen në paragrafin e parë, mund të hyjnë në institucion vetëm me autorizim të drejtorit të institucionit.

Këta persona, në rast refuzimi pa shkaqe të arsyeshme të dhënies së autorizimit nga drejtori i institucionit, kanë të drejtë të ankohen te Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve.

Për përfaqësuesit e komuniteteve fetare zbatohen rregullat e parashikuara në nenin 42 të këtij ligji.”.

Neni 21

Neni 46 shfuqizohet.

Neni 22

Në nenin 50 bëhen këto ndryshime:

- a) Paragrafi i dytë ndryshohet si më poshtë:

“I burgosuri ka të drejtë të ankohet në instancat më të larta të sistemit të burgjeve dhe, kur kjo ankesë nuk zgjidhet në rrugë administrative, apo ndaj vendimit të dhënë, i burgosuri mund t'i drejtohet gjykatës së vendit ku ndodhet institucioni.”.

b) Paragrafi i tretë dhe paragrafi i katërt shfuqizohen.

Neni 23

Në nenin 55 bëhen këto ndryshime:

a) Paragrafi i parë ndryshohet si më poshtë:

“I dënuari mund të vendoset nën regjimin e mbikëqyrjes së veçantë për një periudhë jo më të gjatë se 3 muaj, kur:”.

b) Paragrafi i dytë ndryshohet si më poshtë:

“Të dënuarit nën regjimin e mbikëqyrjes së veçantë, me urdhër të drejtorit të institucionit, i kufizohet vetëm pjesëmarrja në veprimtaritë e përbashkëta ose ajrosja në grup.”.

Neni 24

Neni 59 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 59

Lejet shpërblyese

Të dënuarve, të cilët respektojnë rregulloren e brendshme të institucionit, kanë sjellje të mirë dhe nuk paraqesin rrezikshmëri shoqërore, për realizimin e interesave të tyre emocionale, personale, ekonomike dhe kulturore, drejtori i institucionit mund t'u japë leje shpërblyese, kohëzgjatja e të cilave, në total, nuk mund të jetë më shumë se 20 ditë në vit.

Për të dënuarit e mitur, kohëzgjatja e lejeve shpërblyese nuk mund të jetë më shumë se 20 ditë për çdo rast të dhënies së saj dhe, në total, nuk mund të jetë më shumë se 45 ditë në vit.

Lejet shpërblyese janë pjesë e trajtimit rehabilitues dhe zbatimi i tyre ndiqet nga punonjësit e shërbimit përkatës.

Leja shpërblyese i jepet:

a) personave të dënuar deri në 3 vjet burgim, pasi të kenë vuajtur jo më pak se 1/4 e dënimit;

b) personave të dënuar nga 3 deri në 10 vjet burgim, pasi të kenë vuajtur jo më pak se 1/2 e dënimit;

c) personave të dënuar mbi 10 vjet burgim, pasi të kenë vuajtur jo më pak se 2/3 e dënimit.

Sjellja e të dënuarit vlerësohet e mirë, kur gjatë vuajtjes së dënimit, në mënyrë të vazhdueshme, i dënuari ka shfaqur ndjenjë përgjegjësie e sjellje korrekte me punonjësit e institucionit, me të dënuarit e tjerë dhe gjatë veprimtarive kulturore e punës së organizuar nga institucioni, si dhe ka krijuar besimin e një qëndrimi të mirë jashtë institucionit. Mosdhënia e lejes shpërblyese motivohet vetëm si masë disiplinore, në përputhje me shkronjën "dh" të nenit 53, si dhe në rastet e një situatë të jashtëzakonshme.

Leja shpërblyese në burgjet apo seksionet e sigurisë së lartë jepet vetëm me urdhër të Ministrit të Drejtësisë ose me autorizimin e tij nga Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve.

Në rast refuzimi, i burgosuri mund të ankohet në gjykatë, e cila vendos për kërkesën për dhënie e lejes.”.

Neni 25

Neni 60 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 60

Leje të veçanta

Drejtori i institucionit mund t'u japë të dënuarve leje të veçantë, në rast të sëmundjeve të rënda, të cilat rrezikojnë jetën e anëtarëve të familjes, të vërtetuar me raport mjekësor, apo të ngjarjeve të rëndësishme familjare, si vdekje, lindje apo martesë. Kjo periudhë përfshihet në kohën e vuajtjes së dënimit.

Leja e veçantë mund të jepet deri në 7 ditë dhe, me kërkesë të të dënuarit, mund të zgjatet për aq kohë sa e diktojnë rrethanat.

Në çdo rast, kohëzgjatja e lejes së veçantë nuk mund të jetë më shumë se 30 ditë.
Në rast se dhënia e lejes refuzohet nga drejtori i institucionit, i burgosuri mund të ankohet në gjykatë, e cila vendos për kërkesën për dhënien e lejes.
Dhënia e lejes së veçantë i komunikohet menjëherë strukturave të Policisë së Shtetit, ku do të qëndrojë i dënuari.”.

Neni 26

Neni 62 shfuqizohet.

Neni 27

Në nenin 63, paragrafi i fundit ndryshohet si më poshtë:
“Ulja e dënimit bëhet me vendim të gjykatës, në bazë të kërkesës së të dënuarit apo përfaqësuesit të tij, ose të drejtorit të institucionit.”.

Neni 28

Neni 64 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 64
Ndryshimet në gjendjen civile

Drejtoria e institucionit i evidenton, në një regjistër të veçantë, faktet e lindjeve, martesave apo vdekjeve të ndodhura në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale me burgim, si dhe informon autoritetet përgjegjëse, për të bërë shënimet përkatëse në regjistrin e posaçëm të gjendjes civile, në të cilin nuk pasqyrohet statusi i personit si i burgosur.

Drejtoria e institucionit duhet të njoftojë menjëherë autoritetet gjyqësore, zyrën përkatëse të gjendjes civile, familjarët dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve për vdekjen e të dënuarit.

Në këto raste kufoma vihet menjëherë në dispozicion të familjarëve dhe, kur nuk ka të tillë ose kur refuzohet marrja, vendoset në varreza publike. Për vdekjen e të dënuarit me shtetësi të huaj dhe për vendosjen e tij në varrezat publike njoftohet Ministria e Punëve të Jashtme.”.

Neni 29

Në nenin 67, fjalia e fundit e paragrafit të parë hiqet.

Neni 30

Titulli i pjesës së pestë të ligjit ndryshohet si më poshtë:
“SHQYRTIMI GJYQËSOR I ANKIMEVE DHE ROLI I AVOKATIT TË POPULLIT”.

Neni 31

Nenet 68, 69 e 70 shfuqizohen.

Neni 32

Në nenin 71 hiqen fjalët “ose kërkesës së prokurorit”.

Neni 33

Në nenin 72 bëhen këto ndryshime:

a) Në paragrafin e parë dhe në paragrafin e tretë hiqen fjalët “dhe prokurorit”.

b) Paragrafi i tretë dhe paragrafi i katërt shfuqizohen.

Neni 34

Neni 73 shfuqizohet.

Neni 35

Neni 74 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 74

Ekzekutimi i vendimeve

Vendimet e formës së prerë, që jepen nga gjykata, kur nuk parashikohet ndryshe, ekzekutohen nga drejtori i institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale.”.

Neni 36

Pas nenit 74 shtohen nenet 74/1, 74/2 dhe 74/3 si më poshtë:

“Neni 74/1

Mekanizmi Kombëtar për parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtëruës dhe kompetencat e tij

Avokati i Popullit, nëpërmjet Mekanizmit Kombëtar për parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtëruës, në vijim Mekanizmi Kombëtar, që vepron si strukturë e veçantë nën autoritetin e tij, mbikëqyr zbatimin dhe realizimin e këtij ligji për mbrojtjen e të drejtave të të dënuarve.

Mekanizmi Kombëtar ka këto kompetenca:

a) vëzhgon rregullisht trajtimin e individëve, që u është hequr liria në vendet e ndalimit, arrestimit ose burgosjes, me qëllim që të forcohet, kur është e nevojshme, mbrojtja e individëve nga tortura, trajtimi ose dënimi i egër, çnjerëzor ose poshtëruës;

b) paraqet rekomandime për organet përkatëse, me qëllim që të përmirësohen trajtimi dhe kushtet e individëve që u është hequr liria dhe të parandalohet tortura dhe trajtimi ose dënimi i egër, çnjerëzor ose poshtëruës.

Neni 74/2

Garancitë në veprimtaritë e Mekanizmit Kombëtar

Mekanizmit Kombëtar, gjatë ushtrimit të detyrës së tij, i garantohet:

a) marrja e çdo informacioni në lidhje me numrin e individëve që u është hequr liria, në vendet e privimit të lirisë, si dhe numrin e vendeve dhe vendndodhjen e tyre;

b) marrja e të gjithë informacionit për trajtimin e këtyre individëve, si dhe për kushtet e tyre të ndalimit;

c) hyrja lirish në të gjitha vendet dhe mjediset ku është kufizuar liria e individit;

ç) kryerja e intervistave private, pa dëshmitarë, me individët që u është hequr liria, personalisht ose me një përkthyes kur është e nevojshme, si edhe me çdo individ tjetër që mund të japë informacionin e nevojshëm;

d) zgjedhja lirish e vendeve që kërkon të vizitohet dhe e individëve që kërkon të intervistohet.

Neni 74/3
Format e mbikëqyrjes

Mbikëqyrja e Mekanizmit Kombëtar realizohet nëpërmjet:

a) pranimit të kërkesave ose ankesave nga të dënuarit ose të paraburgosurit me shkrim ose drejtpërdrejt;

b) marrjes së informacionit, ankesave ose kërkesave të të dënuarit, ose nga individë që kanë statusin e vizitorit apo të organeve shtetërore ose organizatave joqeveritare, të cilat kanë kontrolluar apo vizituar institucionin, sipas kompetencës që u njeh ligji, si dhe nga avokati i të dënuarit ose të paraburgosurit;

c) kërkimit të informacioneve nga administrata e institucionit;

ç) verifikimit të dokumenteve, objekteve, pajisjeve ose mjediseve, që kanë lidhje me të dënuarin ose me të paraburgosurin, brenda dhe jashtë institucionit.

Për realizimin e procesit të mbikëqyrjes, Mekanizmi Kombëtar mund të marrë edhe specialistë të fushave përkatëse. Në çdo rast dhe pavarësisht nëse konstatohen shkelje e parregullsi gjatë verifikimit, specialistët e këtij mekanizmi mbajnë procesverbal, i cili nënshkruhet nga drejtori i institucionit ose i ngarkuari prej tij, me të drejtën e pasqyrimin të vërejtjeve.”.

Neni 37

Neni 75 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 75
Trajtimi i të paraburgosurve

Nenet 5 deri 11, 16, 23 deri 28, 30, 32 deri 45, 47 deri 58, 60, 61 dhe 64 të këtij ligji zbatohen edhe ndaj individëve që mbahen në institucionet e paraburgimit, në përputhje me rregulloren e burgjeve.

Në institucionet e paraburgimit ndalohet mbajtja e të miturve në një dhomë me të rriturit, ose vendosja e të miturave vajza me të mitur djem në një dhomë. Të miturit vendosen në dhoma e seksione të veçuara, duke u krijuar mundësinë e një trajtimi të veçantë. Të miturat vajza mbahen nën mbikëqyrjen dhe kujdesin vetëm të një personeli femëror.

Gratë e paraburgosura vendosen në dhoma apo seksione të veçanta nga burrat dhe mbahen nën mbikëqyrjen e kujdesin vetëm të një personeli femëror.

Drejtori i institucionit të paraburgimit, me kërkesë të prokurorit apo gjykatës, kufizon të drejtën e të paraburgosurit për të pritur vizita, për korrespondencë apo për biseda telefonike, kur është e nevojshme për kryerjen e veprimeve procedurale penale.

Të paraburgosurit nuk përfitojnë leje shpërblyese. Me miratimin paraprak të prokurorit dhe të drejtorit të institucionit, të paraburgosurit mund t'i jepet leje e veçantë për:

a) lindje të fëmijës së të paraburgosurit;

b) martesë e fëmijës, vëllait, motrës apo prindit të të paraburgosurit;

c) vdekje e fëmijës, bashkëshortit/es, vëllait, motrës apo prindit të të paraburgosurit;

ç) raste të tjera përjashtimore.

Vërtetimi i fakteve juridike dhe identifikimi i personave të mësipërm bëhen në bazë të dokumenteve të lëshuara për këto raste nga organet përkatëse.

Pranimi i të paraburgosurve bëhet në bazë të dokumentacionit, i cili përmban vendimin e gjykatës për caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg”, procesverbalin e ndalimit ose të arrestimit në flagrancë, procesverbalin e kontrollit personal, formularin e identifikimit, me dy fotot dhe gjurmët e gishtërinjve, dokumentin e kontrollit mjekësor e certifikatën personale dhe dokumentin e identifikimit, pasaportë apo dokument identifikimi të përgatitur nga policia.

Lirimi i të paraburgosurit bëhet vetëm me vendim të gjykatës ose të prokurorisë. Në rast pamundësie objektive për t'u larguar nga institucioni pas lirim, me kërkesën e tij, i paraburgosuri strehohet në institucion, deri në përfundimin e pengesës për largim.

Rregullimi i detajuar i të drejtave dhe detyrimeve të të paraburgosurve, në përputhje me përcaktimet e bëra në këtë ligj, parashikohet në rregulloren e burgjeve dhe në aktet e tjera nënligjore.”.

Neni 38
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.5672, datë 21.3.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

VENDIM
Nr.677, datë 18.2.2008

PËR DHËNIE LICENCE
PËR TELEVISIONIN PRIVAT SATELITOR “TV VIZION+”
SUBJEKTIT: “MEDIA VIZION SHA”

Në mbështetje të nenit 7, pika 21, nenit 24 dhe 136 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe rregullores “Mbi procedurat e licencimit të operatorëve privatë, radio e televizivë”, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. T’i japë subjektit “Media Vizion” sh.a. licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv privat satelitor për një periudhë prej 8 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence.
2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, kushtet teknike dhe tarifat.
3. Licenca me nr.038/TVL, për subjektin televiziv privat vendor “TV Vizion+”, bëhet e pavlefshme.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Mesila Doda (Demi)

VENDIM
Nr.679, datë 18.2.2008

PËR LICENCËN E SUBJEKTIT TELEVIZIV PRIVAT KABLLOR “TV KABLLOR BLU”

Në mbështetje të nenit 7, pika 21, dhe neneve 22 dhe 30 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative”, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. T’i heqë subjektit fizik, z.Mentor Gjuzi, licencën për televizionin privat kabllor “BLU”.
2. Licenca nr.041/RTV kabllor bëhet e pavlefshme.
3. T’i japë subjektit, shoqërisë “TV Blu”, sh.p.k., licencë me të njëjtën përmbajtje, duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv kabllor privat për të penetruar në komunën Golem.
4. Licenca e bashkëlidhur ka të njëjtën përmbajtje me licencën nr.041/RTV kabllor lidhur me kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zona e penetrimit, kushtet teknike dhe tarifat.
5. Ngarkohet administrata e KKRT-së për kryerjen e veprimeve të mëtejshme në zbatim të këtij vendimi.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Mesila Doda (Demi)

KËRKESË
Nr.2075, datë 19.3.2008

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken si rezultat i rehabilitimit dhe zgjerimit të fushës së mbetjeve urbane të qytetit të Tiranës, në fshatin Sharrë.

Subjekti kërkues i këtij objekti është komuna Vaqarr. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkohet të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit, të llogaritur nga Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit pranë Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrat në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit).

Për të gjithë pronarët që në kolonën shënime në tabelën e publikuar është bërë shënimi “Konfirmim nga ZRRPP”, do të kompensohen për efekt shpronësimi pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë pranë komunës Vaqarr (subjekti kërkues, në bazë të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë pronë private për interes publik”).

Vlera totale e këtij shpronësimi është 2 275 269 (dy milionë e dyqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e nëntë) lekë.

LISTA E PRONARËVE, PASURITË NË PRONËSI TË TË CILËVE PREKEN NGA REHABILITIMI
DHE ZGJERIMI I FUSHËS SË MBETJEVE URBANE TË QYTETIT TË TIRANËS NË FSHATIN
SHARRË

Nr.	Pronari			ZK	Nr.Pas	Sip tokë/arë	Çmimi	Vlera lekë	Totali lekë	Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri							
1.	Haki	Fadil	Vladi	3321	138/1	162	537	86994	86994	Konfirmim ZRPP
2.	Qazim	Dervish	Vladi	3321	139/10	3530	537	1895610	1895610	Konfirmim ZRPP
3.	Nezir	Beqir	Muca	3321	146/7	225	537	120825	120825	Konfirmim ZRPP
4.	Qamil	Beqir	Muca	3321	146/8	225	537	120825	120825	Konfirmim ZRPP
5.	Bajram	Beqir	Muca	3321	146/9	95	537	51015	51015	Konfirmim ZRPP
		Totali				4237		2275269	2275269	

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 258 472 (Kryeredaktori)
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2008 është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

1. KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË	600 lekë
2. REGJISTRAT E NOTERISË	1000 lekë

BOTIME TË REJA (Të përditësuara gusht 2007)

KODI PENAL	210 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE	332 lekë
KODI PENAL dhe KODI I PROCEDURËS PENALE (i bashkuar)	542 lekë
KODI CIVIL	408 lekë
KODI I PROCEDURËS CIVILE	224 lekë
KODI I PUNËS	138 lekë
KODI I FAMILJES	244 lekë
KODI I PROCEDURËS ADMINISTRATIVE	88 lekë
• Vendime të Gjykatës Kushtetuese	700 lekë
• Vendime të Gjykatës së Lartë	1000 lekë
• Përmbledhje legjislacioni për nëpunësin civil	200 lekë
• Përmbledhje legjislacioni në fushën e tatimeve dhe taksave	273 lekë
• Përmbledhje e legjislacionit për pasuritë e paluajtshme (Vol. I -192 lekë; Vol. II – 168 lekë, Vol. III – 185 lekë)	

Hyri në shtyp më 1.4.2008
Doli nga shtypi më 1.4.2008

Tirazhi: 3500 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja “Nënë Tereza”
Tiranë, 2008

Çmimi 44 lekë